Fahri Xharra

ANTIKA E MOHUAR

SHKRIME TË ZGJEDHURA

Fahri Xharra

Antika e mohuar

(shkrime të zgjedhura)

Fahri Xharra
ANTIKA E MOHUAR
(shkrime të zgjedhura)

Copyright © autori

Kolona: **Publicistikë**
Lektoroi: **Migena Arllati**
Design & Layout: **ORBIS, Prizren**
Ky libër është i formatit eBook.

Botimet Filozofia Urbane

ISBN: 978-9951-641-38-8
Prishtinë, 2013
www.filozofiaurbane.com
www.librariaelektronike.com

Këto shkrime janë vetëm një pjesë e krijimtarisë së gjerë publicistike të z.Fahri Xharra. Koleksioni i shkrimeve në këtë botim e pasqyron një pedanteri krijuese në funksion të zbërthimit të së vërtetës historike që vazhdimisht është mohuar.

Nevahir Hazeri
koordinator i projektit
LIBRARIA ELEKTRONIKE

Kultura e Vinçes dhe të parët tanë

"Kur kritikojmë per hajni, korrupsion, familjarizëm, degradim, ahmaki, kamishoizëm, xhigavje, sjellje-pshtellje, zhvlerësim, tenderomani, antigjygje, pakurrizoizëm, parainstitucionalizëm e zaptim, këtë nuk po e bëjmë vetëm se po na humbin pak pare këtu e pak aty, pak shance këndej e pak andej. Po e bëjmë se po na humbin ditët, mundësitë e potencialet për të bërë një SHTET. Një shtet që nuk ia "palojnë" xhamadanin të tjerët sa herë që ata kanë qejf, por një shtet që zhvillohet ekonomikisht, politikisht e ushtarakisht aq sa për të prodhuar mirëqenie e siguri për qytetarët e vet. Një shtet që kur flet, megjithatë zgjon respekt e dinjitet."

Lumir Abdixhiku

Kurse unë fjalën e kam për dy shtetet shqiptare.

Po çka lidhje kjo që u tha më lart me Kulturën e Vinçës? Ka bile edhe shumë.

Kultura e Vinçës është një fakt, është një epokë e gjatë historike që nuk mund të përvetësohet nga serbët edhe pse ata pjesërisht sot jetojnë në ato toka ku ishte zhvilluar ajo kulturë, pra Kultura e Vinçës. Por ata po e përvetësojnë.

Në një hapësirë prej Detit Egje e deri në Budapest, nga fushat e Sofjes deri në gjysmën e Bosnjës, është zhvilluar Kultura e Vinçës, kultura më e madhe e zhvilluar parahistorike e Europës. Llogaritet që kjo

kulturë e lashtë në Ballkan, një civilizim 5.000 – 4.000 vjet Para Lindjes së Krishtit, është vazhdimësi e një kulturës së lashtë të Neolitit e cila mbështetej në kohën e zoolitit (burime serbe).

Shtrirja gjeografike e Kulturës së Vinçës

Kultura e Vinçës e ka marrë emrin sipas lokalitetit Vinça, 14 km larg Beogradit të sotëm. Dikur në vitin 1892 në takimin e Shoqatës së gjeologëve të Serbisë, Jovan Zhujoviçiu tërhoqi vërejtjen për vendodhjen e këtij thesari historik. Në vitin 1897 u treguan eksponatet e gjetura aty, dhe u arrit në përfundimin se kishin të bënin me një lokalitet parahistorik ((Nikoliq D. dhe Vukoviq J., 2008 Vinça - nekropoli parahistorik).

Vinça si e tillë është vendbanimi neolit më i famshmi dhe më i madhi në Europë. Këtu ku takohe lagunat e Danubit dhe Beloçicës, gjendej para 45-35 shekuj para Krishtit, metropoli e një kulture tejet të pasur. Nga kjo del që Vinça është një fenomen i cili pasqyron zenitin e kultures së Neolitit në Europë.

Shtresat e shtresimeve historike në thellësi 10.5 metra na japin një pamje rrënqethëse të parahistorisë. Si në një shtrojë të shtrenjtë në vijën vertikale të thellësisë nga sipërfaqja e tokës shtrihen njëra pas tjetrës gjurmët e verdha, të kuqerremta, të përhirta dhe të zeza të formuara nga mbetjet e vendbanimeve të shkatërruara, kolibave të djegura, gropave dhe gropëzave, shpellëzave dhe varreve. Çdo shtresë e tillë i pasqyron fazat e veçanta të posaçme të jetës në Vinçë, të cilat përmbajnë thesarët e vërtetë të materialeve më të ndryshme, që nga armët e veglat prej guri dhe ashti, enëve për përdorim të përditshëm, vazove të zbukuruara në mënyrë luksoze, nga figurinat antropomorfe

dhe zoomorfe, bizhuterive të bëra nga metalet e shtrenjta dhe të rralla, që të gjitha këto të mbaruara në Vinçë.

Vinça është e hulumtuar pak. Në vendin e hallakatur janë gjetur me mijëra gjësende të vlefshme të cilat sot zbukurojnë muzetë e Serbisë dhe të Europës. Vinça nuk është e vetme pasi kultura me emrin e saj dhe të epokës së saj, janë gjetur edhe në lokalitetet e Vërshacit, Kragujevcit, Mitrovicës dhe Prishtinës (duke mos u përmendur gjetjet dhe zhdukjet e gjetjeve në Pejë e Gjakovë). Këto zona bëhen në atë kohë qendra religjioze, e në të njejtën kohë edhe vatra që në masë shumë të madhe ndikojnë në krijimtarinë artistike të Evropës së Mesme dhe asaj Juglindore të kohës së neolitit.

Qindra mijëra figurina, vazot rituale të gjetura në ato vende, tregojnë jo vetëm dhuntinë e madhe të atij populli për art por dhe sajimin e praktikës religjioze në kuadër të kulturës së Vinçës.

Ajo jetë e posaçme e shenjtë, e krijuar në Kulturën e Vinçës, u krijua më së voni 40 shekuj para ardhjes së krishtërimit në këto anë. Këtu u krijuan edhe themelet e mitologjisë së Dimitrit, Dionisit dhe farkëtarit hyjnor të Efesit. Me metodën S-14 është konstatuar se Kultura e Vinçës, kulmin e saj e kishte rreth 37 shekuj para epokës së re." (burime serbe)

Po e përsëris, "… po na humbin ditët, mundësitë e potencialet për të bërë një SHTET, një shtet që nuk ia "palojnë" xhamadanin të tjerët sa herë që kanë qejf por një shtet që zhvillohet ekonomikisht, politikisht e ushtarakisht aq sa për të prodhuar mirëqenie e siguri për qytetarët e vet. Një shtet që kur flet megjithatë zgjon respekt e dinjitet". Pra do të na duhej një Shtet me dinjitet e autoritet ndërkombëtar që të kemi guxim të kërkojmë që së paku t`i kemi edhe njerëzit tanë në zbulimet

e lartpërmendura, sepse zbulimet në fakt ende nuk kanë mbaruar. Historia jonë është më shumë nën tokë se sa mbi të...

Zbulimet më të reja të arkeologëve serbë hedhin dritë në këtë civilizim që mendohej se ishte vetëm bujqësor dhe i përpunimit të qeramikës. Burimet serbe thonë (se ku të marrim ato burime shqiptare për këtë qytetërim): Hulumtimet në lokalitetin e Bellovodës tregojnë se banorët e lashtë të Serbisë (kush ishin ata? F.Xh), e kanë njohur edhe përpunimin e metaleve si dhe kanë ekzistuar minierat e asaj kohe."

Në kohën e përmendur, Belovode ishte metropol i rëndësishëm i Europës. Ky vendbanim shtrihej në sipërfaqe mbi 100 hektarë dhe kishte 700-800 shtëpi. Edhe për përmasat europiane ky do të ishte vendbanim shumë i madh i kohës së neolitit, të cilët zakonisht shtriheshin nga 5 në 10 hektarë. Ky vendbanim ishte themeluar 5.500 vjet para Krishtit dhe ishte zhvilluar deri në vitet 4.500 para Krishtit. Lokalitetin e kishte gjetur një arkeolog amator me emrin Nikola Kërstiq, arsimtar. Ai që në vitin 1950, kishte krijuar hartën arkeologjike të atij vendi (Homolje-Belovoda) duke i shënuar mbi 187 lokalitete arkeologjike dhe ku kishte gjetur vegla e keramikë të ndryshme.

Pikërisht për të gjitha këto që i përmenda do të na duhej të kishim një shtet plot dinjitet i cili respekton edhe arkeologjinë. Por të vazhdojmë me shënimet serbe: Pastaj u zbulua një zbulim sensacional (rrethi i Pozharevcit) me xehe të papërpunuar të bakrit, sipas së cilës vërtetohej se epoka e Vinçes e njihte përpunimin e metaleve.

Ovakvi nalazi upućuju na zaključak da je Vinčanska kultura prva metalurška kultura u Evropi, a možda i u svetu. Sipas përshkrimit të fshatarëve të vendit, thuhet se aty gjenden do xehe të kaltërta (malakit dhe azurit) dhe me hulumtimin e mëtejshëm u zbulua sistemi i kana-

leve dhe gropave, e u gjet xeherorja më e vjetër në Europë. Zbulimi ishte epokal, me përmasa botërore sepse deri atëherë (1995) mendohej se djepi i metalurgjisë ishte Lindja e Afërme dhe se njeriu e njihte përpunimin e metaleve para katër mijë vjetësh, gjë e cila bëri që zbulimi i Belovodes të shtyjë epokën e përmendur edhe për 1.500 vjet (më herët).

Lajmet e fundit bëjnë të ditur se në këtë lokalitet është kyçur edhe Muzeu Britanik, pikërisht për shkak të rëndësisë botërore arkeologjike dhe historike të këtij zbulimi.

"Një shtet që kur flet, megjithatë zgjon respekt e dinjitet", - po siguri-sht, vetëm në atë mënyrë e bëjmë vendin tonë të vlefshëm. Si dhe pse?

Ne nuk dimë t'i ruajmë gjërat tona të cilat fati na i ka lënë në tokat që ne sot i zotërojmë; se ato gjëra që e vërtetojnë historinë tone, vetë i zhdukim apo iu ndihmojmë të huajve që sa më lehtë të na i zhdukin. "Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (të Shqipërisë) sqaroi dje ngjarjen e rëndë që ka ndodhur ditët e fundit të 2012-ës në Kishën e Shën Premtes në Valsh të Elbasanit ku janë shkatërruar në mënyrë të përbindshme afreske të Onufrit. Ministria nëpërmjet drejtorit të saj të Trashëgimisë Olsi Lafe e ka ndjerë për detyrë një sqarim për opinionin publik vetëm sepse media ka publikuar ngjarjen e rëndë dhe ka bërë përgjegjëse ministrinë me gjithë heshtjen e saj. Lafe ka paraqitur një kronologji të ngjarjes dhe qëndrimin e ministrisë, e cila e ka mësuar aktin e dhunës më 2 Janar 2013, kur e ka njoftuar Kisha Ortodokse. Dhunimi i kishës ka ndodhur duke u gdhirë 31 dhjetori. Kemi të bëjmë me një Monument Kulture të Kategorisë së Parë prej vitit 1963. Muret e kishës janë pikturuar nga Onufri në vitin 1554 dhe pasqyrojnë skena të ndryshme biblike. …Nga inspektimi i këtij grupi është konstatuar se afresku është dëmtuar, goditur, prerë dhe shkulur

në mënyrë të dhunshme dhe mekanike nga mjete të forta dhe persona të pandërgjegjshëm dhe të painformuar mbi procesin e shkuljes apo heqjes së një pikture murale. Grabitja është bërë e fragmentuar dhe e fokusuar në pjesët e portreteve të shenjtëve kryesorë të ikonografisë biblike. Në tentativë për t'u vjedhur por në pamundësi për t'u shkulur, ka qenë portreti në figurën e Shën Mërisë me Krishtin tek altari, portreti i figurës së Shën e Premtes (shenjti të cilit i është dedikuar kisha), shkrime të ndodhura në pjesën e brendshme të altarit (ndër to është shkruar emri i piktorit të kishës Onufri), figura mbi nike, pjesë të portretit të dëmtuar të një shenjti në të majtë të absidës (portreti i të cilit është dëmtuar gjatë shkuljes dhe është lënë i fragmentuar. (Shekulli,10.01.13)

Çfarë është bërë në restaurimin e Kulturës së Komanit?

21.01. 2013, Gjakovë

Kalashët e hundëzakëve në rrezik nga zhdukja e përhershme

Qafirstani shihet si parajsë e tokës në Pakistanin Verilindor, e mbushur me liqene të bukur, ujëvara mahnitëse, pyje të gjelbra e të paprekura, borë të përhershme dhe diell të butë. Por nuk është vetëm vendi që të magjeps por edhe bukuria femërore e Qafirstanit. "Femra kalashe me bukurinë e saj e bën edhe mashkullin jo vetëm kalash, të humbë edhe fenë e tij. Kur një grua kalashe pi ujë, i shihet uji duke gjarpëruar teposhtë fytit e saj të gjatë e të bukur". Këto janë përshkrime të zakonshme që i bëhen bukurisë dhe butësisë së femrës Qafire. Ato besohet të jenë më të bardha se e bardha. "Nga lëkura e saj shihen edhe venat të cilat gjarpërojnë nëpër trupin e saj të bardhë."

Por kush janë qafirët?

Këta janë trashëgimtarët ilirë të Aleksandrit të Madh të cilët për mbi 23 shekuj i bënë ballë islamizimit, duke u ruajtur si grup i izoluar (i veçuar) etnik pagan. Gjatë sundimit anglez, historianët perëndimorë u befasuan kur panë ngjashmërinë me vetveten, dhe një kohë të gjatë atyre iu lejua praktikimi i veseve pagane si dhe pirja e alkoolit, verës së përzier me ujë, pije tipike e ilirëve. Por momenti kritik i historisë së hundëzakëve ishte nga fundi i shekullit XIX-të kur atyre iu desh që të islamizohen ose të "zhduken nga faqja e dheut". Por në këtë vazhdë

ishte edhe ndërrimi i emërave paganë të fshatrave dhe çdo gjëje të trashëguar të parëve të tyre.

Mediat pakistaneze filluan së pari të shkruajnë për këtë grup njerëzish gjatë viteve të 70-ta kur Qafirstani u ballafaqua me uri. Duke iu falenderuar kryeministrit Zylfiqar Ali Bhutto (i cili ishte me origjinë nga hundëzakët), u shpall tragjedia dhe paganët shpëtuan, ndërsa Ali Bhutto ishte hero i tyre.

Por, me ardhjen e deobandëve në fuqi, viti 1979 shënoi fillimin e fundit të qafirëve (hundëzakëve). Kush janë deobandët? Një version Ëahabi i islamit, të cilët mëndojnë se vetëm ata dhe ëahabitë duhet të ekzistojnë, kurse sektet e tjera fetare islame duhen të zhduken. Gjenerali Zija Ul Hak (edhe vetë pjesëtar i sektit Deobant) shkoi aq larg sa me anën e tablirrëve (tablirrët, rrjedhë e deobantëve) islamizoi çdo skutë të

Pakistanit. Si rezultat i kësaj, tablirrët (talebanët), u futën me forcë në Qafirstan duke marrë mbi 70 përqind të territorit, duke shkatërruar çdo gjë autoktone hundëzake dhe duke ia imponuar Islamin në mënyrat më të vrazhda.

Rrëmbimimi i femrave hundëzake-kalashe dhe martesat me dhunë për t'i konvertuar në islame, ishin dhe janë një prej metodave të përdorura edhe sot e kësaj dite. Femrave të rrëmbyera dhe të martuara me dhunë, nuk iu lejohej të shihnin të afërmit e tyre përderisa edhe ata nuk e merrnin islamin si fe të tyre. Por nuk janë as fsheftësi dhe as të padëgjuara rastet kur femrat janë shitur sipas mënyrës "se kush paguan më shumë". Hundëzakëve nuk iu lejohet bartja e armëve.

Varfëria e qafirëve është po ashtu faktor tjetër i madh për përqafimin e tablirri-Islamit.

Qeveria nuk jep kredite për qafirët, kurse policia dhe drejtësia shtetërore e Pakistanit nuk kundërvihet kurrë kur sulmohet prona e hundëzakëve. Tablirret luajnë edhe me një letër tjetër duke iu dhënë hundëzakëve para me fajde (që është kundër parimeve), dhe kur ata nuk mund t'i kthejnë më ato, s'u mbetet gjë tjetër ose të islamohen ose të humbasin pronën. Uji i ujësjellësit dhe rryma elektrike është vetëm për myslimanët, kurse kalashët janë të privuar nga ato të mira. Dimri i Qafistanit është Siberik, e kushtet e jetës janë të papërshkruarshme. Xhamitë dhe mejtepet janë të ngrohta dhe me ujë nga ujësjellësi, kurse shtëpitë e kalashëve mërdhijnë e bora duhet shkrirë për t'u pirë.

Gjatë dimrit kalashët flejnë dhe jetojnë së bashku me shtazët e pakta shtëpiake që kanë. Për ta s'ka spitale e as dispanseri. Zmadhueset e zërit nga mejtepet, ditë e natë lexojnë vargje kuranike, kurse shumë kalashë vdesin sepse iu mungon kujdesi edhe më elementar shëndetsor, bile së fundi vdekje janë numëruar edhe gjatë lindjes së grave.

Duke iu falenderuar tablirrëve, kultura autoktone kalashe thuaja se nuk ekziston më. Në vitët e 80-ta flitej se deri në fund të shekullit XX-të, do të arrihet deri te shuarja e kalashëve, por ja që janë ende gjallë nja dy deri tre mijë sish.

Qeveria e Pakistanit ka formuar "Fondacionin Kalash" për shpëtimin dhe propagandimin e kulturës Qafire. Por faktet flasin ndryshe. Vizitorët e Luginës së kalashëve duhet të paguajnë mirë për t'i parë ato vende e ata njerëz.

Bileta që i jepet vizitorit quhet me nënçmim "biletë e kopshtit zoologjik". Duke iu falenderuar këtij fondacioni kalashët janë shndërruar në artifakte antropologjike.

Dhe ironia më e madhe qëndron në faktin se shoqatat për mbrojtjen e kafshëve vajtojnë për zhdukjen e ndonjë lloji të caktuar, ndërsa askush nuk e ngren zërin në mbrojtje të tyre. E tablirrët vazhdojnë shlyerjen e paganëve të fundit evropianë.

16.11.2012

Hundëzakët – Leshkuqët e Lekës së Madh

Aty ku piqen Afganistani, Pakistani, Taxhikistani dhe Kina, aty është Hundëza. Hundëza është mbi 2.500 metra mbi nivelin e detit dhe rrethohet me male 7 mijë metra të larta. Po në këtë lartësi mbidetare e krejtësisht malore prodhohen perimet, pemët dhe drithërat e ndryshëm. Aty prodhohen disa produkte prej të cilave sigurohet jetesa, si psh.: patate, fasule, grurë, elb, shalqi, rrush, qershi, mollë, dardhë, pjeshkë dhe kajsi.

Banorët janë arëbërës (bujq) të mrekullueshëm dhe kanë krijuar sistemin e vet të vaditjes dhe kullimit, kanalet kulluese që quhen KULLSE. Mali i lartë i mbuluar me akullnaja quhet RAKAPOSHI (ra kah poshtë) dhe furnizon luginën me ujë të pijshëm. Banorët që jetojnë në harmoni të plotë dhe kanë shëndet të mirë, të painfektuar nga sëmundje të kohës, janë të njohur në botë se rrojnë gjatë.

Hundëzakët jetojnë rreth 40-100 vjet. Një fëmije të lindur djalë, nëna i jep gji deri në tre vjet, kurse vajzës vetëm dy. Në Hundëzë nuk ka ndarje të çifteve të martuara. E quajnë veten hundëzakë, sepse lugina mes malesh ku jetojnë ka formën e hundës. Gjuha e folur prej tyre është BURRUSHASKI (burrërrishtja), gjuhë e cila nuk shkruhet.

Burrat veshin SHALVARE (shal-vare), ndërsa gratë bluzën e tyre e quajnë KAMISHA. Vallet e tyre shoqërohen nga tupanë, fyej apo pipëza kurse vallëtarët kërcejnë të kapur dorë për dore në rreth. Në raste festash, burrat veshin pelerinë leshi të quajtur çuka. Në tetor është festa e verës (pije alkoolike). Gratë nuk janë të mbuluara me perçe.

Festa më e rëndësishme është ajo e Vitit të Ri Diellor. Ky festim quhet NA UROSH. Në një ditë të vetme të dhjetorit kryhen të gjitha martesat e vitit. Hundëzakët e tregojnë brez pas brezi historinë e tyre se si kanë mbetur aty që nga shekulli III p. e. s. dhe se e kanë prejardhjen që nga koha e Aleksandrit të Madh.

Historiani arvanitas Aristidh Kola, në librin e tij "Arvanitasit" shkruan: Aleksandri i madh, ilir nga nëna e tij, e kishte rritur ushtrinë e tij me ushtarë të zgjedhur ilirë. Por pas vrasjes së Klitit nga ana e Lekës së Madh, atë periudhë e veçojmë se rreth 6 mijë ushtarë ilirë u ndanë nga ky i fundit dhe u veçuan duke u pozicionuar të veçuar në Braktane deri sa u përqëndruan në Qafirstanin e sotëm.

Pra fjalën e kemi për një mori ilirësh (e sot rreth 50 mijë sish) që kanë mbetur aty që nga koha e Lekës së Madh, nga koha e pushtimit të Mbretërisë së Persisë të Dariusit. Vendi i hundëzakëve u quajt Qafirstan për shkak se nuk e pranuan islamizimin. (Qafirstan –vend i jobesimtarëve). Hundëzakët jetuan me mijëra vjet si paganë deri në fillim të shekullit XIX, deri sa Emiri Abdur Rrahman Khan i konvertoi qafirët në islam. (1895-1896).

Pas pushtimit të Emirit të Kabulit, vendi u quajt Nuristan (Vend i Dritës). Qafirstani ishte pushtuar shpesh edhe para Emirit dhe siguri-sht që identiteti i tyre u degradua, "priftërinjtë" e tyre u vranë, qendrat

fetare u dogjën, të rinjtë u morën me zor në ushtri kurse vajzat u detyruan të shkojnë nëpër haremet e khanëve.

Është i pranishëm fakti se hundëzakët edhe sot e kësaj dite, e pinë verën të përzier me ujë si të parët tanë ilirët. Janë popull trupgjatë, me lëkurë të bardhë dhe mollëza të kuqe, shumica e tyre me sy të kaltër, të gjelbër dhe hiri, flokët e verdhë deri në ngjyrëkafe, gjë që i dallon nga afganët, tagjikët apo pakistanezët. Shumë prej tyre edhe leshkuq.

Lart në male jeton fisi karakteristik i Kalashëve. Kalashët janë animistët e fundit të Azisë Qendrore. Si një grup i vogël prej 5 mijë vetash, ata kanë një histori më ndryshe nga hundëzakët e tjerë. Me kalimin e shekujve Qafirstani u nda në dy zona: ajo e qafirëve të zinj që sot janë kalashët, dhe qafirët e kuq, pasardhësit e të cilëve sot jetojnë në Nuristan e që iu nënshtruan xhihadit të Emirit të Kabulit.

Qafirët e zinj jetojnë edhe sot me besimin e tyre Animist sipas të cilit besohet se edhe druri ka shpirt. Me mijëra vjet kalashët kanë ruajtur dhe kanë mbijetuar me kulturën e tyre unike, identitetin social dhe gjuhësor, por shekulli i ri i ka përballur ata me dy sfida të reja: fundamentalizmi fetar dhe ndryshimet klimatike.

Studimi i Hundëzës dhe hundëzakëve ka rëndësi të madhe për kulturën shqiptare sepse ata kanë jetuar me mijëra vjet të veçuar nga rrethi dhe në këtë mënyrë kanë ruajtur të paprekura tiparet popullore, gjuhësore dhe zakonore iliro-shqiptare.

Është interesant që fqinjët tanë kanë guxim që "të pathirrur të kërcejnë në dasmën tonë". Grekët me vite të tëra dërgojnë mësues, hapin shkolla greke dhe e bindin botën për lidhjen e prejardhjes së tyre greke prej hundëzakëve, kurse sllavo-maqedonasit që nga viti 1996 dërgojnë

linguistë sllavë në vendin e kalashëve, për të gjetur kështu vazhdimësi gjuhësore mes gjuhës sllavo-maqedone dhe asaj burrërrishte.

Kurse ironia edhe më e madhe është ajo e vitit 2008 kur kryeministri i FYROM-it, Gruevski, thirri në vizitë princin hundëzak Gacanfer Ali Khanin dhe princeshën Roni Atika, si pasardhës të Lekës së Madh e kjo vetëm e vetëm për të treguar vazhdueshmërinë sllavo-maqedonase me hundëzakët (!). Kurse ne shqiptarët, "dasmës sonë ia vëmë vellon e harresës dhe të mospërfilljes".

Kultura e Komanit

Të shpjegosh rrënjët autoktone dhe prejardhjen iliro-shqiptare, në të njëjtën kohë e bën më të lehtë kuptimin e orientimit tonë properëndimor. Ne kemi mbirë mbi këto troje pellazgo-ilire, shumë shekuj më herët se sa të vinin në Gadishullin Ballkanik grekët, romakët, hunët e gotët, sllavët, e së fundi në shekullin e XV-të edhe osmanët.

"Shqiptarët janë e vetmja rracë në Ballkan që tregon të vërtetën historike", Edith Durham

Në Gajtan të Shkodrës janë gjetur vendbanime të vjetra 6.000 vjet p.e.s, ndërsa në Xarë të Sarandës 10.000 vjet p.e.s. Gjuha jonë është pjesë e trungut të gjuhëve indoevropiane në cilësinë e degës shqipe, pra shumë e hershme, e që na ka afruar më herët se popujt e tjerë të perëndimit. Albert Dymo thotë se nuk ka racë më të vjetër se shqiptarët në Europë. Ilirët gjendeshin në qendrën e saj para se të lindte nocioni i Europës.

Milan Shuflay, George Hahn, Çabej, Mayer, Jokli e të tjerë, vërtetojnë duke e krahasuar rritjen e kësaj bote të lashtë ballkanike me një lis vigan me rrathët e tij vjetorë.

Kultura e Komanit është kulturë e hershme e Arbërisë, që pason kulturën ilire, gjë që do të thotë se bartësit e saj, arbërit, janë shqip-

tarë të hershëm, pasardhës të ilirëve. Zbulimet e bëra në Delmace të Komanit i hapën rrugë një rindërtimi arkeologjik dhe historik, duke u bërë një pikë reference për mënyrën e zhvillimit të Ballkanit Perëndimor në shekujt VI-XIII pas Krishtit.

Gërmimet arkeologjike në Koman janë bërë fillimisht në vitin 1898 nga Konsulli i Francës në Shkodër, Degrand. Nga ato gërmime u gjetën varrezat e mesjetës së hershme, mbi të cilin u bë ndërtimi shkencor i njohur si Kultura e Komanit, që e bënte lidhjen e shqiptarëve si pasardhës të arbërve dhe ilirëve. Për mëse një shekull, varrezat e Delmacës kanë qenë në qendër të vëmendjes së arkeologëve të huaj dhe atyre shqiptarë.

Në Europën Perëndimore, gjetjet në këto varreza u bënë të njohura me emrin "Kultura e Komanit", përderisa sllavët dhe osmanët e kishin rrënuar dhe humbur atë kulturë shumë herët. Delmace është një fshat i Komanit në një lartësi mbidetare 568 metra. Kështjella e Delmacës dhe Kisha e Shën Kollit shikuar kalimthi dhe si zbulim i rëndësishëm për historinë tonë, janë lënë përgjysmë për 50 vjetët e kaluara. Delmace me rrethinë është shumë mahnitëse me fshehtësinë e vet ende jo krejt të zbuluar.

Emrin "Delmace" e gjejmë kryesisht në shkrime ku i njohuri për ne, studiuesi Hahn e krahason me shqipen dele, delmer, bari delesh. Emri Delmace bashkë me gjetjet arkeologjike në varreza, dëshmojnë vazhdimësinë iliro-arbërore në malet e Dukagjinit, si Pukë-Iballë-Spas. A. Dhima e sheh vazhdimësinë edhe në tiparet antropologjike të arbërve të shek. VI-VIII, në banorët e Pukës në masën mbi 70 për qind.

Hulumtuesit kanë studiuar në fushën e toponimeve të Delmacës e sipas Xhemal Meqit, dallohen: Varrezat e Delmacës, mbi një rrafshinë

në jug të kështjellës, Qafa e Delmacës në mes të Kodër Varrezë te Majës së Cungut të shkëmbit të kalasë, Kështjella e Delmaces 4 km në lindje të Komanit, Kroni i Delmacës i humbur mes gurësh, ana perëndimore e Kodër Varrezës e njohur si Masdelmace, Gryka e Delmaces në veriperëndim të Masdelmaces.

Delmace, duke qenë një vend malor, kur ishin të favorshme rrethanat historike të shek. VI-VIII, u bë një qendër me përmasat e një "kulture qytetare" (H. Spahiu "Gjetja e Delmaces", 1971).

Sipas arkeologes Etleva Nalbani, kërkimet shkencore për jetën e Mesjetës së hershme në Kalanë e Delmaces, shtrihen në një sipërfaqe prej 2.500 metrash katrorë.

Aty janë të vendosura në forma tarracash mbi 35 banesa prej guri. Zbulime të rëndësishme e me vlerë janë edhe ato të 300 varreve e që japin shenja edhe për njëmijë varre tjera të pahapura në atë lartësi mbidetare. Zbulimet e tilla e klasifikojnë Komanin edhe si qendër të referencës së mësimit në të gjithë Ballkanin.

Komani si i tillë, i banuar nga popullata ilire, ka qenë një nga metropolet e Ballkanit Perëndimor.

Në kalanë e Delmaces gjenden toponimet e katër kishave si ajo e Shën Kollit, Shën Gjergjit, Shën Mëhillit si dhe Kisha e Zonjës së Mirë. E gjithë kjo tregon se sa e madhe ishte shtrirja e këtij qytetërimi të hershëm, por edhe me rëndësi kishtare e kulturore të Krahinës së Pultit të Sipërm. Zona e epërme e Pultit, së bashku me kalanë e Delmacës në bazë të shënimeve dhe fakteve, toponimeve të mbledhura, kanë qenë qendrat më të mëdha të krishtërimit në këtë rajon.

Për Kishën e Shën Kollit kemi të dhëna shumë me vlerë nga Gjergj Bardhi, 1634, arqipeshkëv i Tivarit dhe ipeshkvi i Sapës, Frang Bard-

hi më 1637. Sipas tyre, famullia e Shën Kollit ishte për tre fshatrat në Koman, Bytyç (Mtyçi Buzhalës), Qerreti i vogël dhe Delmace. Gjergj Bardhi shkruan më 1634-ën: "në Shën Koll janë shenjat se përpara kishte qenë vend i dalluem…", ndërsa Frang Bardhi vazhdon: "me sa kuptohet, këto shenja janë gjurmë të një zhvillimi të hershëm që dalloheshin ndër vendet e tjera të Maleve të Pukës, Iballes dhe Spasit. Me gjithë ekspeditat ndëshkuese osmane në këto male, në Shënkoll kishte ende begati të dukshme…".

Të shkelësh për herë të parë në këtë vend është vështirë të bësh lidhjen mes pamjes mahnitëse ku përpara ke Shurdhanë, Danjen dhe Rozafën dhe shkel mbi qytetërimin e Mesjetës së hershme që ka shumë për të na rrëfyer.

Dikur flitej për varrezat misterioze të veriut, por më 6 janar 1898 konsulli Degrand dha njoftimin i pari për Kulturën e Komanit por edhe vjedhjen e 130 objekteve arkeologjike që i dërgoi në muzetë e Parisit. Historiani gjerman Treger, në vitin 1900 hapi 10 varre dhe gjetjet i çoi në Berlin.

Me 1924, arkeologu italian Ugolini i hapi disa varre të tjera dhe "i mori do materiale për studime të mëtejshme". Studiuesja më e madhe shqiptare ka qenë Hana Spahiu me punën e së cilës u formua teza e Komanit si kulturë më vete. Fakti i një vendbanimi i provuar në mënyrë shkencore nga arkeologët tanë se populli që dikur rronte në kala, i ka rrënjët e tij aq të thella saqë arrijnë deri tek ilirët e hershëm.

Fakti që vendbanimi ishte prej guri, faktet që përdorej metali, ndërtimi i shumë kishave, varrimet e të vdekurve që bëheshin me rroba e stoli, flasin qartë për zhvillimin ekonomik tejet të lulëzuar në kohën e të parëve tanë.

Pastaj pasuan gërmime të tjera që shpërndanë gjetjet arkeologjike në vazhdim nuk përfshinë: kështjellën, kishën e Shën Kollit me kishat e Shën Teodorit në kështjellë, të Shën Gjergjit në Vl. të kështjellës, të Shën Mëhillit, të Shën Gjonit afër kodrës vorrezë, të Shën Ndreut në lagjen Dobra.

Ndërprerja e zbulimeve arkoelogjike në vitet '80 është një faj i pafalshëm shtetëror. Kisha e Shën Kollit me kishat e tjera në afërsi me ndërtimet në kështjellë të Mesjetës së Mesme, flasin për një vazhdimësi ekonomike, shpirtërore e kulturore në këtë zonë e gjerë, deri nga fillimi i Mesjetës së vonë kur pushtuesit osmanë e ndërprenë përfundimisht këtë zhvillim. Sipas Aleksandër Stipçeviqit, "kultura e Komanit është kultura e një populli që në shek. VI-VIII ishte një kapërcyell i të dy epokave, nga ajo e vonë antike, në periudhën e hershme mesjetare. Tipologjia e varreve, orientimi i tyre, inventari i armëve, i veglave të punës dhe i stolive, me praninë e shumtë të simbolikës ilire, e lidhin "Kulturën e Komanit" me të kaluarën ilire të këtyre trojeve dhe me banorët e lashtë të tyre, ilirët".

Duhet të mburremi jo vetëm me zbulimin e varrezave, por të mburremi edhe me krenarinë për një qytetërim të hershëm që të tjerët na e kanë zili. Kultura e Komanit pasqyron shumë bukur mbijetesën pagane dhe atë të krishterë të të parëve tanë.

13 tetor 2012

365 Kishat e Shasit

Qytetërimi shqiptar më shumë ndodhet nën dhe se sa mbi të. Në viset etnike shqiptare në Mal të Zi, e mbi të gjitha në rajonin e Ulqinit, janë një numër i madh i monumenteve të trashëgimisë sonë nga historia jonë e hershme, ku zë vend edhe qyteti i lashtë i Shasit, qytet që sot nuk banohet.

Shasi është vendbanim antik ilir i cili ngrihet në malin po me të njëjtin emër. Këndej pari, në periudhën antike ka kaluar rruga e lashtë lidhëse mes Ulqinit dhe Shkodrës. Shasi në literaturë njihet si: Suatio, Suaço, Savocci, Svaciao, Fshas etj. Baza e qytetit të lashtë është ndërtuar nga gurët e mëdhenj, ndërsa murin rrethues stihitë e kohës e kanë dëmtuar shumë; ky mur bart vlera të mëdha arkitektonike dhe artistike. Edhe sot e kësaj dite aty qëndrojnë dy portat e qytetit.

Shasi për herë të parë u përmend në dekretin e papës Aleksandri i Dytë më 1067 si qytet Ipeshkëvi. Në vitin 1183 pushtohet nga Stefan Nemanja dhe me atë rast barbarët e shkatërruan Shasin. Qyteti u mëkëmb, por përsëri pasoi sulmi i mongolëve më 1242 të cilët e shkatërruan krejtësisht.

Në fund të shekullit XIII zonën e rindërtoi mbretëresha Jelena, dhe përjetoi kulmin e vet qytetar dhe tregëtar deri në shekullin XVI, kur përfundimisht u sulmua dhe u shkatërrua nga turqit më 1571. Nga ky

vit Shasi njihet si "qyteti i vdekur". Në këtë vit turqit e pushtojnë edhe Ulqinin dhe Tivarin, ku banorët vriten dhe qyteteve iu vihet zjarri.

Mirëpo, kur kemi të bëjmë me veprimin kishtar, Shasi ka pasur kisha aq sa ka ditë viti, e kjo është rast unik në botë, kurse tani shihen vetëm themelet e tetë kishave, të cilat i përmend edhe Justiniani (1533) dhe më vonë Marin Bici (1610), katedralja e Kishës së Shën Gjonit, e ndërtuar me stil gotik dhe Kisha e françeskanëve të Shën Mërisë, të lashta rreth 1300 vjet. Të gjitha kishat në Shas kanë qenë të zbukuruara me dekorime arkitektonike dhe afreska, e në disa edhe tani dallohen gjurmët e ngjyrave në mure.

Pjesët e mbetura të fortesës gjenden në shkrepa. Përveç Shasit në periudhën veneciane rreth Liqenit të Shkodrës ishin edhe qytetet Trishti, Danja dhe Sarda.

Arqipeshkvia e Tivarit (mbi 900 vjet) ishte baza kryesore e katolicizmit në Shqipërinë e Veriut, por edhe Ipeshkëvia e Shasit e luante të njëjtin rol për zonën e vet. Në vitin 1443 ipeshkëv i Shasit ka qenë Palë Dushmani. Edhe Pjetër Bogdani e përmend Shasin në shkrimet e tij duke thënë se shtrihet në perëndim mbi qytetin e Tivarit, në veri deri te Kravari dhe në lindje përfundon me lumin Buna.

Sikur të bëheshin hulumtime nënujore, do të gjendej edhe më shumë nga Shasi. Kjo trashëgimi e pahulumtuar nga ana jonë është fshehur nga sllavët me shekuj. Ka edhe fakte që dëshmojnë se gjatë verës, kur niveli i ujit të liqenit të Shasit është i ulët, shihen pjesë të mureve të shtëpive të dikurshme të banimit.

Gjetjet arkeologjike provojnë se qytetin e Shasit të panjohur deri në shekullin VIII, në të vërtetë e prek krishtërimi i hershëm në periudhën ilire. Ilirizmi i kësaj kulture dëshmohet veçmas nga njëjtësia tipolog-

jike e objekteve të kulturës arkeologjike të Shasit me kulturën iliro-arbërore të Komanit.

Pjetri, ipeshkëv i Shasit (Suacinense), mori pjesë në shenjtërimin e katedrales katolike të Kotorrit më 1166. Shenjtërimin e bëri ipeshkvi Majo me Lazrin (ipeshkvi i Shqipërisë) dhe me Gjonin (ipeshkvin e Ulqinit). Ishin të pranishëm edhe Gjoni – ipeshkëv i Tivarit, Gjergji – ipeshkëv i Shenjtit Shpëtimtar të Shqiptarëve, Pjetri – ipeshkëv i Shirgjit (në lindje të Bunës) dheAndria– ipeshkëv shqiptar. Pra, shumicën e autoriteteve fetare të këtij manifestimi e përbënin klerikët katolikë shqiptarë, ku përfshihet edhe Pjetri, ipeshkëv i Shasit.

Shasi më herët u shndërrua në hapësira me vende të fortifikuara, sikurse tregon pozicioni i tij në luftën në mes Papatit dhe Bizantit për të zotëruar këtë qytet në kohën e mesjetës. Hulumtimet në lokalitetin e Shasit të vjetër dëshmojnë për ekzistencën e vendbanimit parahistorik si bazë ku është ngritur qyteti i Shasit pasi që u bë zbulimi i kulturës së Komanit, me anë të të cilit u bë përcaktimi më i saktë i datimit të objekteve sakrale që kanë ekzistuar që nga shekujt VI-VII. Ky vendbanim i lashtë, përveç rëndësisë strategjike jepte edhe kushte të përshtatshme për jetë, duke u parë edhe vendndodhja e tij në liqenin e Shasit dhe Bunën të pasur me peshk, zogj, shtazë të egra dhe kushte të tjera të veçanta për blegtori dhe bujqësi.

Duke iu referuar një shkruesi të panjohur dhe dorëshkrimit të tij "Dulcigno secondo l'antica descrizione…", thuhet se në këtë trevë gjendej qyteti shumë i vjetër i quajtur Shasi, ku duken gjurmët e 365 kishave larg nga Ulqini 15 milje. Më tej shkruan: "Afër këtij qyteti gjenden liqeni, shpella, burimi i ujit dhe mali Lisinjë, Ledhet e Shasit dhe porta ku vdiq Kapedani i Qesarit, duke luftuar tmerrësisht kundër

Pompejanit ku janë edhe sot në këmbë dhe si mrekulli një gropë e madhe, ende e parrafshuar…”

Nuk ka dyshim se Shasi mesjetar si qytet i zhvilluar është përjetësuar edhe në numizmatikë, sepse i ka farkuar monedhat e veta, të cilat mbanin mbishkrimin Suacium, si dhe ajo që e paraqet figurën e Shën Palit Pagëzuesit, si mbrojtës i qytetit, si dhe pirgun dhe kështjellën me porën madhështore të këtij qyteti.

Versionet malazeze te kësaj periudhe cekin se Stefan Nemanja (shek XIII) i shkatërroi kishat shqiptare dhe librat e kohës, kreu konvertimin me dhunë të banorëve të mbetur në ortodoksë, gjë e cila përputhet me traditën gojore në Shas, ku banorët tani të fshatit Shas thonë se të gjitha kishat në fillim ishin katolike.

Në keto vendbanime kemi të bëjmë me një popullsi albane – shqiptare autoktone, vazhduese e popullsisë së hershme ilire, e formuar historikisht shumë shekuj përpara depërtimit sllav dhe atij osman në këto treva. Këto të dhëna të dorës së parë kundërshtojnë dhe hedhin poshtë hipotezat shkencore dhe antishqiptare të disa autorëve të huaj borgjezë, e sidomos të atyre sllavë, të cilët orvateshin të paraqitnin popullsinë shqiptare të kësaj ane si joautoktone, si të ardhur më vonë nga tokat e brendshme shqiptare, aty nga fundi i shek. XVII dhe fillimi i shek. XVIII, pas luftërave austriako-turke (1683-1690). Edhe shumica e toponimeve të Anës së Malit janë dëshmi se ato i kanë emërtuar për herë të parë shqipfolësit që i kishte shënuar administrata e kohës në frymën e gjuhës shqipe, me një influencë të vogël nga administrata sllave dhe ajo osmano-turke, si: Shën Gjergji, Shën Koli, Shën Todri, Shën Petra, Shën Andre, Shën Shirgji, Shën Mrija, Zogaj, Ifshas (Shasi), Gjonza, Kryqi (Kruqi), Bukmir, Krroqi, Bardoni (Bardhoni), etj.

Këto e disa të tjera toponime të kësaj ane janë rregjistruar sipas natyrës së gjuhës shqipe dhe me forma të shqipes, e jo me format sllave, siç i hasim vendbanimet e tjera shqiptare në viset e tjera, të kalkuara ose të përkthyera në gjuhën sllave nga administrata mesjetare sllave, si: Sveti Gjorgje, Sveti Nikola, Sveta Marija, Sveti Andrija, Bardoniq – Beliq, Palabardh – Bjelopavliq, etj.

Kërkimet e para të arkeologjisë jugosllave që u takojnë viteve 1980, zbuluan një hershmëri më të madhe se ajo që dihej. Ishte pikërisht trashëgimia ilire e kulturës së Shasit që e trembi shkollën arkeologjike të Beogradit. Në vitin 1985 Akademia e Shkencave të Serbisë me ng-uti ndërpreu hulumtimet, kur vërejtën se kanë të bëjnë me një qytet të lashtë shqiptar. Ky pra është qyteti ilir i 365 kishave, që në fillim u shkatërrua nga sllavët e pastaj e vërteta e gërmadhave të tij u fsheh po ashtu nga sllavët.

Vetëm ne, si njohës të mirë të vetvetes, dhe duke mos i mohuar rrënjët tona, mund ta shkruajmë historinë ashtu siç duhet.

P.s: Një falenderim i madh publik për prof. dr. Iljaz Rexha, dr. Simë Gjon Dobreci dhe Marjan Dodaj, si dhe portalit Visit-Ulcinj.com, që më ndihmuan në përgatitjen e këtij materiali.

Antika e mohuar, Kale-ja e Bujanocit

M`u desht të lexoja materiale nga prof. Frank Ë. Ëalbank-u (1909-2008) që të gjej se çfarë fshihte dhe ende fsheh nëntoka jonë. Këndej pari ku jemi sot dhe ku ishim dikur, andej pari ku të parët tanë jetonin dhe lundronin përgjatë historisë, andej pari ku kemi mundësi t`i qasemi e nuk duam, por edhe andej pari ku nuk guxojmë as ta përmendim që ishte e jona.

"Me një punë sistematike 4-vjeçare me mbetjet arkeologjike (2001-2004) në lokalitetin Kale-Kërshevica afër Bujanovcit, u gjetën mbetjet e objekteve arkitektonike të epokave të ndryshme kronologjike, të cilat i themeluan kolonistët grekë (?-F.Xh) nga fundi i shekullit V (para Krishtit). Koha e zhvillimit bie në fundin e periudhës heliniste të vjetër dhe fillimin e shekullit IV para epokës së re." (Miroslav Jeremiqi, Beograd SANU)

Ndërsa Frank Ë. Ëalbank shkruan: "Për mua ishte shokues fakti që mitologjia e grekëve jepte të dhëna edhe për emrin dhe popullin e Dardanisë. Megjithëse grekët me zotat dhe emrat e tyre e kanë provokuar në mënyrë provokuese historinë, shumë të dhëna të pakontestueshme tregojnë rrënjën e Dardanëve, dhe se ishin Dardanët ata që krijuan

familjen mbretërore të Trojës... Prej Dardanusit e kishte prejardhjen familja mbretërore e Trojës dhe kjo rracë shquhej edhe për bukurinë, edhe trimërinë e saj". Pra ?

Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë zbulon një thesar historik të pamatshmëm në nëntokat ku ende jetojnë shqiptarët (Bujanovci) dhe pa fije fytyre thotë se u gjet një trashëgimi ndërtimore antike tradicionale në Kale të Bujanovcit, një trashëgimi helenistike. E ne shqiptarët ende merremi me ekzistimin tonë fizik andej pari!

Kanë kaluar mbi 40 vjet nga gjetjet e para në Kërshevicë të Bujanocit e deri më sot ku kemi një zbulim shumë të madh (Popović Petar). Vendi i quajtur Kale në fshatin e përmendur u zbulua më 1965-ën nga Milan Jovanoviqi (në kohën kur Rankoviqi ende ishte në fuqi), kurator i muzeut të Vranjës. Materialet e botuara në vitin 1968 paraqitën një zbulim epokal në këto anë, akropolin me suburbiumin (ndërqytetin) e një madhësije të çuditshme. Gjatë hulumtimit të kompleksit në vitin 2008, u zbulua një ndërtesë në formë bureje (fuçije) e cila i takon objekteve të rralla të ruajtura të shekullit IV p.e.s dhe në tokat tona (në Serbi, Petar Popoviq) si shembull i vetëm arkitektonik. Gjatë hulumtimeve po tregohet që tërësia arkitektonike është shumë më e madhe me struktura të urbanizuara të cilat shtrihen përgjatë lumit të Kërshevicës.

Në fshatin e Kërshevicës (Bujanoc) në jugun e Serbisë, gjendet një plato mbi lumin me të njëjtin emër ku zbulimet e një sektori të urbanizuar tregojnë shenja të Epokës së Bronzit e deri tek Epoka e hekurit (shek XII-VII p.l.k) , me shumë shtresa të mbushura me mbetje arkeologjike që datojnë shek IV-III p.l.k. Damastioni, sipas gjeografit grek Strabonit, ishte një qytet i vjetër që arriti kulmin në kohën e Filipit të II-të të Maqedonisë dhe të Lekës së Madh (burimet serbe). Damastioni

ose Damastumi në regjionin ilir, sipas të gjitha gjasava ishte në kufirin e Kosovës së sotme, e njohur për kohën e saj të argjendit dhe minierave të argjentit. Sidoqoftë Straboni e përmendte Damastionin duke mos e precizuar saktë vendndodhjen e tij, kurse monedhat e argjendta të gjetura vijnë nga Kosova, Maqedonia Lindore dhe Serbija jugore (Mali Rujan në Kërshevicë, 15 km në Jug-lindje të Vranjës (Popoviq P.). Burimet e tjera tregojnë që qyteti ishte i banuar nga fisi iliro-dardan. Damastinët të mbretëruar nga Mbreti i tyre Bardhyli. Qarkullimi i monedhave të argjendit të Damastionit ishte nga Dardania dhe Brigjet e lumit Morava (burimet serbe). Gjetja e monedhave të argjendit tregonte që atë kohë bëhej një jetë luksi. Ndërsa J. J. Ëilkes në librin e tij "Ilirët" thotë: "Damastioni, monedhat e argjendit dhe vetë jeta e atëhershme mbesin një mister". Mbesin mister sepse kishte mohime. Atëherë pse "Kërshevica" e Bujanovcit të mos jetë Damastoni (i Strabonit) i Bujanovcit, i Dardanisë, Ilirisë e Pellazgëve?

Nxjerrja e pellazgëve nga lashtësia me anën e gjurmëve të tyre të shumta si dhe vendosja e tyre në një sfond historik, në të vërtetë ka hapur në mënyrë të pashmangëshme çështjen e vazhdimësisë së tyre, pra të pasardhësve të drejtpërdrejtë të ilirëve dhe të dardanëve, e cila është dashur të përcaktohet nga diçka që nuk ka të bëjë as me grekët e as me romakët, që megjithatë ata kanë qëndruar "diku në mes, por pse në këtë mënyrë një faktor i rëndësishëm dhe i merituar në familjen indoevropiane". Në njërën anë kjo qartëson pozitën e vet brenda për brenda gjenealogjisë së rrënjëve dhe trungut të saj shumëdegësh ku shqipja shfaqet me një degë të vetme, dhe në tjetrën anë hiqen dilemat rreth vendit dhe rolit të pasardhësve të pellazgëve në raport me vehten dhe të tjerët, veçmas kur dihet se ata shtriheshin në një hapsirë

gjeografike ndër më të rëndësishmet dhe po ashtu kur dihet se nga pikëpamja etnike shoqërore dhe më vonë edhe politike, do të jenë aktorë të të gjitha zhvillimeve nga ato parahistorike deri tek ato historike.

Gjithnjë sipas burimeve që vijnë nga autorët e antikës, edhe ndarja në Pellazgë dhe "Barbarë", ruan të fshehtën e një kapërcimi historik midis pellazgëve "hyjnorë" dhe pasardhësve të tyrë të drejpërdrejtë "tokësorë" - Dardanëve dhe të tjerëve nga kjo familje e gjerë, kapërcim ky që sipas të gjitha gjasave lidhet me Trojën dhe historinë e saj të lavdishme. Sidoqoftë dardanët si bij të pellazgëve, me një shtrirje tepër të gjerë, nuk i gjejmë vetëm tek mitologjia greke dhe romake, por edhe tek poetët edhe dramaturgët grekë të antikitetit, kështu tek Homeri heronjtë e Iliadës ishin kryesisht pellazgë." (Jusuf Buxhovi, "Kosova")

Pra pa u hamendur, këndej pari ku jemi sot dhe ku ishim dikur, andej pari ku të parët tanë jetonin dhe lundronin përgjatë historisë, këndej pari ku kemi mundësi t`i qasemi e nuk duam, por edhe andej pari ku nuk guxojmë as ta përmendim që ishte e jona, janë gjurmët tona.

Ne, Serbia dhe Europa

Nëse "politika është art i së pamundurës" (Bismarku), atëherë a dijmë ne të bëjmë politikë? Nëse historia është pasojë e një apo shumë manipulimeve, si duket kjo e jona? Kur politikën nuk e bën vetë sepse të mungon përvoja, pjekuria dhe mbi të gjitha aftësia e gjeturisë diplomatike në raste të vështira, atëherë si do ta shkruash historinë tënde kur mijëra libra kanë mbushur raftet e bibliotekave familjare dhe ato publike të mbarë Europës, duke mbajtur vulën e një propagande të fëlliqur anishqiptare? Në këtë rast këmbëngulja për t'u thirrur në universalizmin njerëzor si një mjet që sjell dobi në njohjen e drejtë dhe mirënjohjen e të kaluarës sonë nga të tjerët, është pak dobiprurëse. "Përfundimi është sa i thjeshtë, aq edhe i ndërthurur për t'u shpjeguar: "Duhet të kemi parasysh që investimet sllave në perëndim përsa i përket deformimeve të historisë, kulturës, traditave shqiptare në përgjithësi, janë të shumta dhe të vjetra në kohë dhe i kapërcejnë shekujt." (B.T.) A e dijmë ne nivelin e propagandës anti-shqiptare që zhvillohet nëpër botë? Në këtë prizëm duhet të shikojmë se sa ne ndihmojmë që kjo propagandë të zërë vend. A jemi të vetëdijshëm se sa të forta janë lobet sllave në Perëndim? Rrjeta e tyre është e shtrirë dhe është e kapur në nivelet më të larta të shtetit, pushtetit, politikës dhe akademive universitare perëndimore. "Ne shqiptarët jemi të mangët dhe komplet të paorganizuar në drejtim të promovimit të his-

torisë, kulturës dhe traditave tona në perëndim edhe sot që flasim në shekullin e 21."(B. T.) Çka na pëlqen të themi ? Ne e dijmë që shteti Shqiptar dhe ai i Kosovës janë të paorganizuar, të painteresuar dhe komplet të pamotivuar në këtë drejtim. Sa investojnë dy shtetet shqiptare në këtë drejtim? Na pëlqeu apo jo, një përgjigje është e saktë, që në nivel ndërkombëtar, si Shqipëria ashtu edhe Kosova, janë absolutisht të pafuqishme dhe të parëndësishme. Për Homerin dhe Odiseun, në botë llogaritet që janë shkruar mbi 5.000 libra që na rrëfejnë të "vërtetën" mbi Itakën, Greqinë dhe gjuhën greke që ata flisnin. Kjo ta zëmë është "lashtësia". Për Manastirin e Deçanit apo Patriarkanën e Pejës: si do ta bindësh UNESCO-n se ato janë shqiptare, së pari katolike e pastaj ortodokse shqiptare? Ç`ti themi vetes që, që prej fillimit të demokracisë në tokat tona e deri më sot, në botë janë shkruar mbi 50 libra të cilat "vërtetojnë" prejardhjen joshqiptare të Skënderbeut. E në këtë rast, edhe ne jemi kontribuesit dhe argatët më të mirë në propagimin e këtij përshtjellimi. Po luan historia me ne apo ne po luajmë me historinë? Si do t`i kundërvihemi kësaj të keqe. Sa kohë duhet, sa para duhen, që të rikthejmë vëmendjen e Europës në atë çka shkruante Marin Barleti? Me gjithë dëshirën e mirë që mund të ketë një individ ose një grup individësh privatë, është fakt se nuk mund të përballohesh me një makineri gjiganteske propagande antishqiptare, që funksionon në regjim të plotë prej shekujsh, sidomos nëse individët privatë nuk kanë mbështetje ekonomike, politike, akademike për lobim. Ku jemi ? A thua po jetojmë sot për nesër, ose a e planifikojmë që të jemi një vazhdimësi e ndershme e vetvetes? "Konkluzioni është sa i thjeshtë, aq edhe i komplikuar për t'u shpjeguar: duhet të kemi parasysh që investimet sllave në perëndim për sa i përket historisë, kulturës, traditave sllave në

përgjithësi, janë të shumta dhe të vjetra në kohë e kapërcejnë shekujt. Në këtë prizëm, nuk duhet të na çudisin propagandat anti-shqiptare që lexojmë qoftë në internet ose edhe në nivel akademish dhe universitetesh. Lobet sllave në perëndim, përfshirë dhe Italinë, Francën, Britaninë e Madhe, janë shumë të forta dhe kapin nivelet më të larta të shtetit, pushtetit, politikës dhe akademive universitare. E majta italiane p.sh. ka patur lidhje të ngushta me vendet komuniste të lindjes sidomos me Rusinë, duke nisur që nga momenti i krijimit të Partisë Komuniste në Itali që para një shekulli e deri në ditët e sotme." Por ajo që është më dramatike dhe e tmerrshme është fakti se shqiptarët janë të parët që ndërrthurin interesat e tyre me antikombin, duke u bërë pjesë e një ingranazhi antiperëndimor dhe material të dorës së parë të propagandës antishqiptare (B.T). Ne punojmë në mënyrë të pandërgjegjshme kundër vetë kombit shqiptar, historisë dhe të vërtetave shqiptare, atyre të vërtetave që qëllimisht nuk bëheshin të njohura, atyre të vërtetave që janë të vërteta dhe që me zbardhjen e tyre ndërrohet historia. Më vjen ndërmend Faik Konica dhe shkrimi "Armiqt' e Shqipërisë" që ai e botonte në numrin e parë të revistës së tij "Albania" (1897). Në atë editorial, ai thotë se armiqtë e Shqipërisë nuk janë as greku, as serbi, as turku, por janë vetë shqiptarët, sepse ata nuk e duan lirinë e tyre, sepse, sipas tij, ata nuk bëjnë asgjë për të shpëtuar vendin e tyre. Po ne si veprojmë sot që të ndryshojmë nga bashkëkohësit e Konicës ? Cilat lobe veprojnë në tokat tona? Pro apo kundrashqiptare? Iu kundërvihemi ne atyre apo bëhemi "ortakë" me ta në përdhosjen e historisë, të krenarisë dhe vazhdimësisë sonë shqiptare? Në trojet shqiptare, më duket se ligjin e bëjnë lobet orientalo-aziatike të ndërsyera dhe të përshtatura nga ato sllave, kështu që detyrimisht shqiptarët

i janë futur pa e kuptuar as vetë një lufte që po kryhet prej kohësh dhe që ka të bëjë me zonat e influencës gjeo-ekonomiko-politike të lobeve dhe masonerive të ndryshme botërore. Trojet shqiptare janë epiqendra e kësaj lufte interesash për vetë pozicionin gjeografik që kanë. Deri sot, më duhet të them me dhimbje të madhe se shqiptarët vazhdojnë të jenë në kahun e gabuar dhe janë duke punuar kundra vetvetes, me shumë zell drejt vetëshkatërrimit. Ende nuk jemi duke e zgjedhur mikun e vërtetë. Në një botë që sa vjen e po kthehet në më globaliste, të parët që do fillojnë të humbasin identitetin dhe etnicitetin e tyre, duke rrezikur drastikisht të shkrihen si komb, janë shqiptarët. E di që është e tmerrshme ajo që sapo shpreha por ky është realiteti që unë e shoh. Ma thoni ju lutem nëse është ndryshe dhe unë e kam gabim! (B.T.) Me kënd jemi ne? - Jemi me dreqin e mallkuar. Jemi me dreqin e mallkuar kur shkruajmë: "Ndërkaq, që emërtimi Kosovë dhe kosovar ngërthen brenda vetes një përkatësi etnike shqiptare, njëkohësisht shpreh një identitet të dallueshëm si bashkësi shtetërore dhe politike, të ndryshme në zhvillimin historik, ngjashëm me emërtimin zviceran, që shpreh një bashkësi shtetërore supernacionale (Besëlidhja Helvetike). Kosovarët e sotëm, shumica me një identitet të qartë, shqiptarë etnikë (etnia është statike), nëse arrijnë që shtetin e tyre ta anëtarësojnë në OKB, atëherë ata do të jenë një komb i veçantë, (kombi është variabël) ndonëse vazhdojnë të jenë shqiptarë etnikë, porse tashti si "njësi e rritur".(Urs Altermatt.) Në rastin kosovar, veçantitë identitare, politike dhe historike e të shtetkrijimit, vështirë mund të kontestohen. Sot kosovarët identifikohen me këto veçanti dhe me shtetin e tyre si e drejtë e arrirë, prandaj nuk janë futuristë fantastë (të llojit të Zhyl Vernit, F.Xh) ata që mendojnë për këtë komb të ri." Zhyl Vernë e shkuar Zhyl Vernit.

Prapë dhe me këmbënguljen me të paarritëshme, së bashku me lobistët e kësaj propagande të krijimit të një sajese jashtëtokësore.

Duke biseduar për këtë çështje, një mike imja më shkruan: "Ajo që ka rëndësi është që tematika dhe thelbi i artikullit të kuptohet nga lexuesi e të ndezë në kokat e tyre mendime dhe pikëpyetje të cilave duhet të jenë në gjendje t'u japin pergjigje e njëkohësisht edhe zgjidhje. Lexuesi nuk duhet ta shohë ketë problematikë si diçka të pashpresë, por duhet të kuptojë se ka edhe rrugë alternative. Lexuesi duhet të kuptojë se impenjimi nuk duhet t'i mbetet vetëm e ekskluzivisht shtetit, pasi që shteti nuk është një organizëm abstrakt por përbëhet nga njerëz/individë, e këta duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rolin që luajnë në këtë epokë të historisë dhe shoqërisë shqiptare. Artikulli i shkruar duhet të ndezë ndienjën dhe detyrën e përgjegjësisë qytetare edhe tek ajo pjesë e shqiptarëve që kanë mjete ekonomike për të krijuar si në vendin amë ashtu edhe jashtë, bazat për krijimin e insitucioneve të fuqishme të lobimit." Kurse tjetra mike më shkruan: "Por problemi nuk është vetëm bota, por ndërgjegja e shqiptarit, dhe nuk mjafton krenaria për të qenë burra... duhet ndershmëri intelektuale që ne akoma nuk e kemi. Rrijmë me sy të mbyllur vetëm nga patrotizmi. Duhet patriotizëm në politikë dhe ndershmëri, jo patriotizëm por atdhedashuri në politikë dhe ndershmëri në prezantimin tonë në botë".

Ne ishim aty, Meduni Labeat Ilir!

"Sot kudo bëhen gërmime për të gjetur vendbanime ilire, romake: amfiteatër, obelisk, qypa, poçe, etj., por askund nuk kërkohet gjë nga perandoria e një epoke sepse nuk ka mbetur asgjë. Bile asnjë qyp për turshi! Shtëpia me qerpiç shembej me vdekjen e pronarit!"- Lis Bukuroca Na e shponin qiellin dhe vetevetiu duhej që vazhdimisht të mbanim kokën lart, jo nga krenaria por nga frika e ngulur në zemrat tona se çdo gjë vjen prej së larti. E dija që nga lart bie shiu, bora, breshëri por kurrsesi të kuptoja se çfarë ishte ajo se pse nuk guxoja të shikoj shumë nëpër tokë. Më sollën parmendën që të gërrithi pak tokën e të mbjell farën tonë të rritjes, por kurrsesi mos të shpurrdhi thellë në tokë. Prapë na e shponin qiellin e nuk dinim që na përpinte një rrymë e ftohtë që na bënte të mos të na bjerë ndër mend që të mendojmë për të parët tanë. Kushërinjtë e mi të largët, në vertikalen historike, mundoheshin që me krraba të arrnonin ato pjesë të shpuara të qiellit tonë por binin viktimë e vetë kërrabës. Qielli vazhdonte të shpohej. Prapë dilnin të tjerët që pasi u zbulua gjilpëra, të qepnin sa mundnin por nuk e kuptonin që gjatë punës e humbnin vetëdijen. Ishin do çekana të mëdhenj dhe thonin që binin nga qielli. (?) Toka nuk guxohej të shpohej e as bile të thellohen themelet e shtëpive të rralla që ndërtoheshin. Edhe

për qerpiç, gropa e lloçit nuk guxohej të ishte e thellë sepse frika kishte hyrë në asht. Së pari kishin frikën shpuesit e qiellit; atyre iu kishte hyrë frika deri në palcë se nëse ne gërmonim në nëntokën tonë, rastësisht mund të gjenim gjëra me të cilat na rritej krenaria, na shtohej guximi dhe i dilnim përpara disa gjërave. Porse ne frigoheshim vazhdimisht nga i nalti, dhe edhe kur flenim i mbanim sytë nga tavani deri sa të na merrte gjumi. Të përgjumur apo jo, ne duhej që të flenim, që të flenim sa më gjatë dhe të mos gërmojmë në tokën e nënës dhe të atit tonë që na e kishin lënë, dhe që shpuesit e qiellit na e kishin zaptuar. Flej, flej, se sa më shumë të flesh më shumë rritesh – na thoshnin.

Neve flinim, edhe nëntoka jonë flinte. Por të tjerët nuk flinin; nuk flinin ardhësit e rinj mbi ne. Sidoqoftë, Meduni është ish akropoli i një qyteti të madh ilir, të fisit të madh të Labeatëve, dhjetë kilometra në verilindje të Podgoricës. Që nga kohët ilire datojnë shkallët në brigjet e një mali të cilat të dërgojnë në një vend ku ilirët kryenin ritualet e tyre fetare të lidhura ngushtë me kultit e tyre-gjarpërin. Nekropoli është në veri të qytetit dhe daton nga Koha e Hekurit. Meteoni ose Medioni është qytet i ngritur nga fundi i shek IV p.l.k. i cili së pari është përmendur nga historiani romak Titus Livius (59 p.l.k - 17 ps.k) duke u shënuar si vepër e Labeatëve, fisit ilir që jetonte rreth Liqenit të Shkodrës i njohur si Lacus Labeatis. Qyteti kishte domethënien fortifikuese dhe bënte lidhjen e Adriatikut me Dardaninë. Sipas pozitës, mënyrës së ndërtimit, konstruktit të mureve, Meteoni (Meduni) ishte një qytet i rëndësishëm Ilir i Labeatëve, me një karakteristikë të qyteteve të fortifikuara të asaj kohe, me akropol dhe me mure "Ciklope". Çdo gjë që është zbuluar e gjetur, të vërteton përdorimin fetar. Meduni është dëshmitar i një historije të bujshme që nga luftërat ilire e deri në ditët e

sotme. Meteoni ilir sot është Meduni malazez. Në veri të qytetit, ndër pyje, gjenden tumat e mbuluara me gurë. Ato shtrihen në rrafshinë por deri më sot nuk janë hulumtuar shumë. Tuma të njëjta gjenden edhe në jugperëndim të Medunit. Aty është edhe nekropoli por i pahulumtuar deri në fund. Varret këtu janë të rrethuara me bloqe të ç'rregullta prej guri. (Wilkes, J. J. The Illyrians, 1992). Për shkak të rëndësisë së pozitës së saj jashtëzakonisht strategjike, Meteoni (Meduni) është konsideruar si "çelësi i dy Zetave". Pamja e sotme e Meteonit është një pjesë e ruajtur i dy kullave gjysëmrrethi, mureve mbrojtëse, dyerve dhe objeketeve të shtuara në shekullin e Mesëm. Në mesin e mbetjeve mesjetare është edhe Kisha e Arkigjakonit Stefani (e ndërtuar mbi themelet e kishës së vjetër) si dhe varri i "Vojvodës Mark Milani, heroit dhe shkrimtarit të njohur malazez". Nën fortifikatën mesjetare, gjendet shtëpia e lindjes së Mark Milanit e cila pas vitit 1971 është shndërruar në Muze Memorial. (Ju kujtohet Mark Milani i Kuqëve !). Në një sipërfaqe prej 250 mijë metrash katrorë, po bëhet sanimi dhe restaurimi i kompleksit arkeologjik-historik-kulturor të Medunit, me qëllim të vlerësimit shkencor dhe turistik (shënimet nga Muzeu i Malit të Zi në Podgoricë). Me shumë vlerë dhe kureshtje duhet të përmendet teknika e ndërtimit të mureve e cila të kujton atë të Daorsëve (300-50 p.l.K), fisit tjetër Ilir, si dhe një ngjashmëri me civilizimin amerikano-jugor në Machu Pichu. Blloqet e shfrytëzuara për ndërtim nuk janë të përmasave të njëjta, por ashtu saktë lidhen njëra me tjetrën sa që as fletëza më e hollë nuk mund të kalojë përtej. "Në Malin e Zi të sotëm, ishin shumë vendbanime të mëdha ilire, të vogla dhe të mëdha, por dy prej këtyre venbanimeve historike të mëdha janë Meduni dhe Dukla. Ilirët e vjetër kanë ndëtuar dhe ngritur qytete që shkojnë mileniume larg para nesh në kohë

dhe me madhësira monumentale." (Semir Osmanoagiç) "Është për t'u habitur heshtja jonë në shpjegimin e ndërtimit të blloqeve të gurit të cilat janë kryevepër e përpunimit dhe ndërtimit të kullave të Medunit. Duhet të ceket se legjionet romake pushtuan Medunin rreth vitit 167 p.l.K. Me atë rast Mbreti ilir Genci së bashku me familjen ishin kapur... Ndërtimet ilire ishin të njëjta në të gjithë Adriatikun, me teknikën e ndërtimit kundër tërmetit dhe me blloqe të përmasave të ndryshme." "Në tokën e sotme të Malit të Zi kanë jetuar Labeatët dhe Dokleatët; derisa Meduni ishte kryqendra e Labeatëve, Dokleatët ishin të shtrirë në luginën e plleshme të lumit Zeta me qendrën e tyre në Duklea. Duklea me dhjeta mijëra banorë, ishte qendra më e madhe e populluar e kohës pararomake. Që në atë kohë, domethënë para pushtimit romak, qyteti i gurit kishte sistemin e ujësjellësit, rrugëve të shtruara me pllaka, hedhjet e ujërave të zeza me kanalizime dhe të gjitha përballjet e tjera urbanistike". (Bojan Zeçeviq) Në të përditëshmen malazeze "Pobjeda", kolumnistja Olivera Ugrin shkruante se "Meduni është qyteti i fortifikuar që s`peshohet me ari" (Pobjeda, 27.09.08) "Fleni, fleni dhe fleni se rriteni", na thoshin e po na thonë. E ne vazhdojmë të flejmë me shpresë se do të rritemi në humnerën e të pakthyeshmes, në grumbujt e plehut të cilët vetëm kundërmojnë deri sa të treten.

Falenderoj z.Mirsad Çapriqi për ndihmën e dhënë për këtë punim.

Pse heshtim ne? Pse e duam historinë pa heronjë?

Kur një populli i mohohen heronjtë, qëllimi është i qartë. Por kur ne ia mohojmë historinë dhe heronjtë tanë trashëgimisë sonë, atëherë i japim të drejtë dreqit e fatkeqit, që të na hudhë në shportën e mbeturirave historike, si një pjellë e ardhur rastësisht në këto anë, si një sajesë artificiale e sjellur nga dikushi për qëllime të dikushit. Ne po jetojmë ndoshta vetëm e vetëm që t`i shërbejmë dikujt si makinë e lindjes, për mbushjen e racës së po atij dikujt ?

Heshtja e të së kaluarës sonë, heshtja e bëmave mbi ne, ishin të qëllimta. Ishin "kujdestarët" që kujdeseshin që ne të mos dijmë se çfarë po ndodh me ne. Ishin "kujdestarët" që na e fshihnin të kaluarën, që për hië të asaj ose kësaj, të mos dimë se çka është bërë mbi ne. Garantuesit e heshtjes historike, gjithmonë në një mënyrë apo tjetër, na e pasqyronin vetëm atë që neve na mbetnin shumë gjëra të paditura. S`donin që ne të kemi një krenari nga e kaluara, edhe pse ajo ishte një përulje, një shembje e mllefeve shekullore mbi ne. Thjesht, kujdesshin që të mos kemi se çka të mbajmë në mend. Apo që të mos kemi se çka të bartim tek brezat e rinj. Nëse në botë flitej e shkruhej drejt për ne, neve nuk na mundësohej të kishim qasje në këto shkrime. Arsyet ishin të ndryshme,

por të gjitha me një qëllim: "shqiptarët nuk guxojnë të shkollohen, janë raca më e zgjuar e Ballkanit dhe nëse ata e njohin të kaluarën e tyre, paraqesin rrezik". "Kisha rastin që fatbardhësisht apo fatkeqësisht, gjatë kohës sa zgjaste lufta (1912), të vizitoja Uskubin (Shkupin), disa ditë pas luftës së Kumanovës. Më bëheshin pengesa artificiale që unë mos t`i vizitoj ato anë, nga një ndërgjegje jo e pastër e atyre që i bënin ata gjëra. Një gjeneral (serb) që unë e njihja që më pare, kur e mori vesh cakun e udhëtimit tim, me një armiqësi të pafshehur më tha se nuk kisha arsye që unë të vizitoja Shkupin. Por kur e pa vendosmërinë time, atëherë më tha se do të shoh gjëra të pakëndshme, por që nuk mund t'iu ikësh (Lev Trotsky: "Luftat Balkanike 1912-1913"). Pra ishin "gjëra të mëdha" shtetërore të cilave nuk mund t'iu ikësh. Dikush duhej të kishte shënime mbi ato tmerrre. Kush? Forcat ushtarake? Qeveria serbe? Po që po. Por ne jo, as në kohën kur ato kanë ndodhur e as deri tani. Ne nuk guxonim të dinim dhe na mashtronin me gjëra të tjera më të "këndshme". "Tmerret, vazhdon Trotsky, filluan të shihen posa iu afruam Kumanovës. Çdo gjë rreth nesh ishte në flakë. Fshatra të tërë shqiptare ishin shndërruar në gërmadha zjarri e shkrumbi. Kjo ishte për mua përshtypja e parë e vërtetë e një shktatërrimi të pamëshirëshëm të parë në një zonë lufte. Vatrat, pasuria e krijuar nga etërit, gjyshërit e stërgjyshërit, zhdukeshin nga flakët. Kjo pamje e zjarreve na përcolli deri në Shkup. Posa zbrita nga vagoni, ishte natë, askund asnjë njeri i gjallë: përveç zërava të dehur të ushtarëve dhe kësaj skene që pashë. Katër ushtarë i mbanin bajonetat të gatshëm, kurse në mes dy shqiptarë shumë të rinj me plisat e tyre në kokë. Komitaxhinjt (çetnikët), në dorën tjetër mbanin shishen e rakisë dhe jepnin urdhër: "Përtokë shtrihuni!" dhe shqiptarët binin në gjunj dhe ngriheshin në urdhërin tjetër.

Disa herë. Pastaj çetniku i dehur, duke i kërcënuar dhe sharë, i shponte me majën e thikës herë në fyt e herë gjoks, duke i urdhëruar që të pinin raki nga shishja e tij. Të dehur nga fuqia e armës dhe nga rakia e gjaku, argëtoheshin duke luajtur me ta. "Ata janë Arnaut", më thoshte shoqëruesi", dhe së shpejti do t`i prejnë". (Lev Trotsky) Por edhe kur na jepet mundësia që ta dijmë, ta njofim dhe ta bartim tek brezat e rinj të vërtetën tonë historike, ne i kemi edhe sot ato grupe "intelektualësh", ato grupacione joqeveritare të cilat kujdesen që vëmendjen e botës ta bartin tjetërkah, mu andej nga botës i vjen për të vjellë. Kemi vetëdije ne? Gjatë okupimeve serbe të territoreve shqiptare, gjithmonë është përcjellë si një qëllim spastrimi etnik dhe asimilimi i shqiptarëve me forcë. Edhe sipas planeve të Garashaninit, i ngjashëm me Megali Idean greke, ishte grumbullimi i të gjithë serbëve dhe krijimi i një ekspansioni tokësor për atë që gjoja të gjejnë përsëri "Madhështinë Serbe Mesjetare" e cila nuk ka ekzistuar asnjëherë. Përderisa serbët ia japin dhe ia kanë dhënë vetës "të drejtën historike" mbi tokën shqiptare, ne nuk kemi pasur mundësi të flasim, sepse kemi qenë në mbrojtje të ndereve të huaja. Dhe krenohemi me këtë besnikëri. Krenohemi me këtë besnikëri dhe thurrim lavde. Edhe tani, për inat të së vërtetës historike, ne mundohemi të bejmë diçka. Të bëjmë atë për të cilën serbët kanë luftuar në luftën e tyre diplomatike dhe kanë arritur që ta bindin botën se ne nuk jemi ata që jemi, por jemi të atillë siç po tregohemi. Në shpalljen e Pavarësisë në vitin 1912, Serbia punonte kundër nesh. E ne i kishim haxhiqamilët që dilnin në mbrojtje të "babës". Edhe sot kur po krenohemi me Pavarësinë e shtetit të dytë shqiptar, prapë neohaxhiqamilët thirren, çirren, trumbetojnë për një të kaluar të errët. E duan ringjalljen e asaj që ka vdekur që moti. E duan ringjalljen e të njëjtës,

asaj së cilës ne këtë vit ia festojmë 100-vjetorin e vdekjes. Duke e heshtur të kaluarën tonë, mbjellim dyshimin tek të tjerët se ndoshta ne i turpërohemi asaj. Duke i heshtur tmerret e përjetuara, i themi botës se nuk na dhimbset asgjë nga e kaluara e jonë. Duke dalur me qëndrim të njëjtë haxhiqamilian, qëndrim njëqindvjeçar, nuk bëjmë gjë tjetër vetëm se e trashim teorinë e armiqve, se ne jemi po ashtu dhe po ata siç kanë thënë të tjerët për ne. Mohimi i vetvetes ka hyrë në modë. Kush e kush më shumë mundohet të mohojë, të përbaltë dhe të fusë në vorbullën e pikës së zezë çdo gjë që është shqiptare. Mohimi i vetvetes në psikologji njihet si një hap para çmendisë. A jemi apo më mirë të them a janë disa shumë afër kësaj kataklizme personale? Si mendohet që në kohën e sotme, kur më së shumti i duhemi vendit tonë, më shumë se kurrë i duhemi tokave mbarëshqiptare, ne të mohojmë të gjallë e të vdekur? Kush po na e porosit këtë mënyrë mendimi ? Nëse me qindra vjet është punuar në mohimin e çdo gjëje shqiptare, pse tani vetë ne duhet ta vazhdojmë atë tezë ku ata patën më së shumti sukses? E dimë ne që në vitet e 12- ta të shekullit të kaluar, atëherë kur çdo gjë vlonte në dëmin tonë, çfarë bënte Serbia? E dimë ne, që në atë kohë Parisi e Londra, nën organizimin e intelektualëve serbë dhe Kishës serbe, gumëzhonin vetëm antishqiptarizëm? Si dhe sa, si dhe pse, përgjigjen e gjeni në shumë faqe interneti. Po ne? Për shembull ta zëmë që kishim dalë nga një burg 500 vjeçar e sytë tanë të verbuar nga errësira shekullore nuk shihnin gjë. Po sot? Drita e syrit, rrezet e së vërtetës sonë, gati që nuk thërrasin me zë, ne i vejmë syze të zeza vetvetes (syze të salduesve), që të mos shohim se çka po ndodh me ne. Histori pa heronj! Kush janë përkrahësit e kësaj ideje të mrekullueshme që na sjell në grupin e kombeve pa komb, pa etni, pa histori ? Në kohën kur sot e kemi të qa-

rtë të kaluarën tonë, ashtu si një edhe një që bëjnë dy, e bishtërojmë atë duke e mohuar tërësisht. Histori pa heronj! Në shkrimin "Bëhu i ditur të jesh i lirë" ("Korrieri", 30 nëntor 2008) gjen "mrekullira shkencore". Sipas kësaj gazete: "Duke cituar librin e ri dhe tronditës të Nathalie Clayer, Lubonja tregon që ky mit u promovua nga austro-hungarezët të cilët morën një mit shqiptaro-sllav që ekzistonte në zonat e Shpuzës dhe të Podgoricës, ku Skënderbeu paraqitej si luftëtar sllav, dhe e shndërruan në një hero të popullit të ri që po formësohej në brigjet e Adriatikut. Lubonja thotë: me mite nacionaliste ashtu siç janë farkuar ata një shekull e gjysëm më parë dhe përforcuar me frymë totalitare nga diktatura komuniste… Në se fëmijëve tanë do t'u tregojmë gënjeshtra, edhe ata do të vazhdojnë të tregojnë gënjeshtra e ne do të vazhdojmë të kultivojmë kulturën e rrenës dhe manipulimit." ("Bëhu i ditur të jesh i lirë", "Korrieri", 30. 11. 2008). Kur një populli i mohohen heronjtë, qëllimi është i qartë. Por kur ne ia mohojmë historinë dhe heronjtë tanë trashëgimisë sonë, atëherë i japim të drejtë dreqit e fatkeqit, që të na hedhë në shportën e mbeturinave historike, si një pjellë e ardhur rastësisht në këto anë, si një sajesë artificiale e sjellë nga dikush për qëllime të dikujt. Ne po jetojmë ndoshta vetëm e vetëm që t`i shërbejmë dikujt si makinë e lindjes, për mbushjen e racës së po atij dikujt? "Në Shqipëri, për turpin e kombit, po tentohet për të krijuar një filozofi të robërisë, një doktrinë të robërisë, ndërkohë ne jemi shqiptarë por edhe gjysmë robër. Ne jemi i vetmi popull në Evropë që rrezikojmë të damkosemi me një turp të tillë, të themi që kemi qenë të pushtuar pra, jemi identifikuar si ato prodhimet biologjike të modifikuar. Përse nuk u modifikuan grekët, rumunët, sllavët… Pse ne duhet të modifikohemi?" (Ismail Kadare)

Pse i vranë Aristidh Kolën dhe Luka Çiçipin ?

Biri i Arbërit i njihte thellë dëshirat e heshtura që flinin me shekuj në ëndërrat e dëshirës për një të vertetë; sepse vuajtjet, vdekjet dhe zhdukjet na e kishin rënduar gjithmonë shpirtin. Biri i Arbërit shpresonte në lindjet e bardha mbi errësirën verbuese, të lagura me gjakun e nxehtë të vrasjes së të vërtetës. Edhe pse ishim të pafjetur, në netët e gjata të ankthit, në pritje të llahtarisë, vullkani i përvëluar i brendisë shpirtërore të Birit të Arbërit, e prishte heshtjen e së paarritshmes. E njihte Arbërinë edhe në valët e Drinit dhe kërcimet e tij mbi ujin e pafajshëm jepnin shenjën e dallandyshes në kërkim të lirisë, lirisë që aq guximshëm e kërkonte me vargjet e tij të mbushura me thjeshtësi, me rima të padukshme dhe me simbolet e papritura. Poeti nuk vdes sepse Drini ushton nga dhembja që ai ia dha vlerën valëve të tij. Poeti nuk vdes sepse Biri i Arbërit në qiellin tonë i ka skalitur vargjet që i bëjnë dritë po atij Drini, edhe në netët më të errëta të vërtetësisë sonë. Do ta lëmë të prehet i qetë shtatë pashë lart në qiellin arbëror. *"Vritmëni ,por gjakun ma mblidhni… se do t'u duhet niprave e mbesave për të shkruar gjuhën Shqipe !"*
Petro Nini Luarasi

Por edhe bijtë e mëdhenj të kombit Aristidh Kolën dhe Luka Çiçipin, do t`i lëmë të qetë të prehen diku lart në qiellin arbëror, të prehen

të qetë për punën e tyre të madhe se edhe këta shpresonin në lindjet e bardha mbi errësirën verbuese të mohimit dhe stërmohimit të një pjese të madhe të Arbërisë dhe arvanitasve, pikërisht nga ata nga të cilët e panë dritën dhe kulturën aty ku e vodhën me themel. Që të dy, si Aristidhi ashtu edhe Luka, vdiqën në mënyrë të njëjtë, nga e njëjta "sëmundje" e përgatitur në laboratoret antishqiptare, nga një "sëmundje" e cila sjell heshtjen e të tjerëve për të mos u dëgjuar zëri i së vërtetës së mbyllur me shekuj në shtatë pashët e thellësisë së harresës; duhej patjetër të harrohej se: "Ka pak njerëz në Greqi që nuk e kanë gjyshen apo gjyshin arvanitas", dhe duhej që të mos përmendej se "Greqia sot i ka 695 fshatra shqiptare ku jetohet shqip, frymohet shqip", duhet të mos përmendet kurrë që: "Çamët dhe arvanitasit që jetojnë në Greqi përbëjnë një komunitet prej afro 3 milionë banorësh, ndonëse sot jo të gjithë flasin shqip". Ata duhet të vdisnin sepse kthjellonin ujin e turbullë të historisë; duhej të vdisnin se pastaj në ujin e pastër do të rriteshin troftat të cilat do ta ndërronin emrin e habitatit dhe në atë ujë të pastër. Të gjithë do të shihnin valën e së vërtetës. Aristidhi dhe Luka e dinin se kur shkruanin nëpër gazeta dhe dilnin në TV, shkonin në shtigje me rreziqe të mëdha, por i kishin marrë parasysh të gjitha, si dhe gjënë më të keqe ! E ajo i gjeti se u munduan dhe patën sukses në rrugëtimin e tyre. Plot akuza dhe "shigjeta me helm" do të hidheshin kundër tij. Më 24 maj 2000, një ditë përpara prezantimit të librit të tij, kushtuar arbëreshit të njohur uratë Antonio Belushit, me titull "Antonio Belushi dhe magjia e traditës popullore", Aristidh Kola do të shtrohet urgjentisht në një spital të Athinës i sëmurë rëndë. Më 11 tetor 2000 në spitalin Evangjelizmos në Athinë vdiq arvanitasi i shquar Aristidh Kola i cili rënkonte prej një muaji. Aristidh Kola ishte studi-

ues, shkrimtar, publicist dhe ka botuar disa libra për çështjen e arvanitasve dhe të Kosovës. Ai gjatë viteve 1995-2000 ishte njëri nga zërat më të fuqishëm në Greqi, që mbronte çështjen e Kosovës duke denoncuar masakrat serbe në shtypin grek. Shërbimet dhe kujdestarët e heshtjes ia arritën qëllimit. E njëjta "sëmundje" do ta "gjejë" edhe Luka Çiçipin i cili po ashtu nuk deshti të heshtë ndaj një të vërtete të madhe dhe në mënyrë shkencore shpërndante polenin e kulturës së lashtë arvanite, në mënyrë që bletët e së ardhmes të dinë saktë për emrin e luleve polendhënëse. Luka Çiçipi, profesor i Antropologjisë dhe Gjuhësisë në Universitetin Aristoteli të Selanikut (Greqi), vdiq të dielën në 14 shtator 2008. I lindur në Athinë në vitin 1946, ai u doktorua në antropologji nga Universiteti i Uiskonsinit, pas përfundimit të dy magjistraturave, një në antropologji dhe një në gjuhësi, në të njëjtin universitet (1981). Ka shkruar librin "Antropologjia gjuhësore e praktikës dhe ndryshimit (dyndjes) gjuhësor: arbërishtja (shqipja) dhe greqishtja në kontakt, "A Linguistic Anthropology of Praxis and Language Shift: Arvanitika (Albanian) and Greek in Contact" (Clarendon Press, Oxford 1998) dhe dy libra në greqisht: "Hyrje në antropologjinë e gjuhës: Gjuha e ideologjisë dhe performansa" (Gutenberg, Athens 1995) dhe "Nga gjuha si objekt në gjuhën si veprim" (Nissos, Athinë 2005), ndërsa një libër nën titullin "Gjuha, praktika, dhe ideologjia: Një qasje dinamike e proceseve sociolinguistike", ishte në punë e sipër në kohën e vdekjes së tij, sipas kontratës me Palgrave Macmillanin. Ka publikuar gjerësisht në revista të tilla si Ëord, Language in Society, Journal of Pragmatics, Semiotica, International Journal of the Sociology of Language, Anthropological Linguistics, Journal of Sociolinguistics, Journal of Linguistic Anthropology, Pragmatics etj., mbi çështje të tilla si ideologjitë gjuhësore, teo-

ria politike dhe gjuha, aspektet performuese të gjuhës, teoritë e veprimit shoqëror dhe gjuhësia antropologjike. Ai ishte anëtar i shoqatave të ndryshme të Greqisë dhe ndërkombëtare (duke përfshirë edhe Shoqatën Antropologjike Amerikane, Shoqatën Ndërkombëtare Pragmatike dhe LSA). Ai ishte pionier në studimin e gjuhëve të pakicave në greqishte, në kontaktin gjuhësor. Si e gjeti vdekjen që nuk e deshti por ia sollën? Sot në Greqi, ata që flasin në publik në lidhje me marrëdhëniet e hegjemonisë, rreth arbërishtes apo cilësdo gjuhë tjetër të pakicave, janë në shënjestër nga kërcënimet e stilit të "Agut të Artë". Kështu individi veçohet dhe në fund eliminohet fizikisht, kudo ku është e mundur. Për fat të keq, kjo është Greqia e sotme dhe e gjithëhershme kur janë në pyetje Arvanitasit. Ç`bëri Luka Çiçipi? Në një prej teksteve të tij të fundit mbi gjuhën si një 'praktikë', Luka huazon nocionin e nënshtrimit të mbarështuar nga shkencëtarët politikë (Laclauja, Mouffeja) për të përcaktuar hapësirën e mjegullt (të paqartë) në të cilin një subjekt është në vartësi nga vendimet hegjemonike të 'tjetrit'. Vendimet hegjemonike të tjetrit: Harroje! "Luka me punën e tij na tregoi se si mekanizmat e hegjemonisë arrijnë të mbajnë larg nga arena politike debatin e një çështjeje që nuk artikulohet fare. Cila është ajo çështje? Mos fol shqip! Mos trego se nga lindi shqipja! Mos e përmend të kaluarën tënde se me të bota e merr vesh se unë jam i ardhur pas teje ! Mos…mos…mos ! "Ne këtu flasim vetëm greqisht", thuhet në Greqi e referencat shfaqen në kontekstin komunikativ ku ironia është mbizotëruese, ku arbërishtja çdo ditë e më shumë po i humb folësit e saj amëtarë të fundit, aktivë dhe pasivë. Lluka Çiçipi vdiq me kancer, mundet i të njëjtit lloj si Aristidh Kolis, dhe vdiq në kulmin e tij shkencor. Pse duhej të vdiste Aristidh Kola në Greqi? Sepse "Arvanite të këndomi/ Gluhenë të mos

harromi", kjo nuk lejohet... nuk guxon të jesh arbëror dhe nëse je autor i veprave "Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve", "Gjuha e perëndive", "Deklarata e Bashkimit Arvanitas", "Fjalori korrigjues i fjalëve arvanite", "Fjalori krahasues i gjuhës shqipe", "Greqia në kurthin e serbëve të Milosheviçit", "Kënga e mercenarëve, prejardhja e grekëve", "Mithi dhe e vërteta", "Varrimi i tretë i Marko Boçarit", atëherë të pret vdekja. "Pse ia sharrojmë vetes degët që kemi nën këmbë? Me fustanellën tonë krenohen fqinjët duke e quajtur pjesë të etnografisë së tyre kombëtare. Pasi na zvogëluan gjeografikisht të tjerët, pse për fajin tonë vazhdojmë të zvogëlohemi shpirtërisht? E kryesorja: pse pra ne e kemi humbur shansin historik për t`u bërë qendra e mbarë botës arbërore-arvanite-shqiptare?", - pyet Kolec Traboini dhe vazhdon: "Parë në këtë sy, mund të them se diku përtej gardhit tonë, në Greqi, patëm fatin të njohim Aristidh Kolën, personalitetin më të madh arvanitas të shekullit XX dhe një nga njerëzit më të ndritur të kombit tonë." Vetëm pse mbronte shqiptarët e Kosovës në të drejtën e tyre për liri, u kërcënua publikisht në një emision televiziv nga një gazetare. Për këtë ngjarje skandaloze në median greke, shkruante: "Shumë miq më telefonuan për të shprehur indinjatën për baltën që hodhi mbi mua zonja Liana Kaneli gjatë emisionit televiziv në "Skaj" në 5 maj 1999, dhe më pyetën përse e përballova me qetësi, kur duhej të kundërsulmoja... Miqtë e mi, mos u mërzisni e mos u hidhëroni për këtë, sepse "e drejta del, vjen kur t`i vijë ora... (Nga: "Rrënjët tona janë në Arbëri"). Aristidh Kola me krenari, me guxim dhe vetëdije të plotë thoshte: "Kam preferuar gjithmonë të shkoj kundra rrymës e jo të shkoj nga shkon rryma dhe fryjnë erërat. Nuk jam lëpirë e nuk kam puthur kurrë këmbët e përmjerra dhe për këtë e paguaj shtrenjtë dhe në mënyrë të përditëshme me nder-

in, dinjitetin dhe lirinë time…" Studiuesi arbëresh Antonio Belushi në një akademi u shpreh: "I madhi Aristidh Kola është i pavdekshëm. Ai ndodhet shumë lart në pavdekësi".

Dervish Cara dhe Gordana Jankullovska !

Segregacioni kombëtar dhe gjuhësor në Maqedoninë e z. Gordana Jankullovska-s është shumë ndjellakeq; është për të ardhur keq që pushteti i një shteti që mbahet në këmbët prej qelqi, nuk do që të vërtetën e së vërtetës ta shohë me sy të kthjellët. Ka raste kur syri vuan nga shkurtpamësia, dhe atëherë vihen syzet pasi më parë na është caktuar dioptria. Shkurtpamësia politike si e tillë vjen ose nga mosdija, ose nga qëllimet që prekin shumë larg, por pa një përllogaritje të saktë për atë "largpamësi". Është për të ardhur keq që në një shtet ku shqiptarët janë ata që janë, qofshin myslimanë apo ortodoksë, bëjnë një numër aq të madh saqë më të gjitha mjetet e mundshme mundohet të fshihet. Kështu bëhet një segregacion kombëtar dhe gjuhësor ndaj tyre.

" Nuk ka nevojë që Ueb faqja e MPBM-së të jetë edhe në gjuhën shqipe", ka deklaruar ministrja e Punëve të Brendshme të Maqedonisë, Gordana Jankullovska në pyetjen që i është bërë rreth faktit se pse ajo faqe është vetëm në gjuhën maqedonase. Informatat që janë në këtë faqe interneti, sipas saj, janë të mjaftueshme dhe "janë të kuptueshme për të gjithë qytetarët e vendit". Bukur shumë ! "Familja e Musli Ahmedovit u largua javën e kaluar nga Velesi duke u vendosur në Shkup, pas shumë presioneve që ajo të braktisë shtëpinë e saj dhe të largohet nga ky

qytet ku shqiptarët siç thuhet janë të padëshirueshëm". E keni dëgjuar këtë lajm ju znj. Jankullovska ? Sigurisht që po. E pamundur që të mos e kishe dëgjuar. Dhe... ? Historikisht është vërtetuar që shtetet nuk shkatërrohen brenda natës. Farat e shkatërrimit të tyre janë të mbjella thellë në institucionet shtetërore. Pellazgët kanë thënë që një e mirë e arritur pa mund, ndodh që të shkaktojë të vjellura që s`kanë të ndalur. Mirëpo, për këtë flasim më vonë. Zonja Jankullovska, keni dëgjuar për Dervish Carën? Nëse jo, do t` iu tregoj. Dervish Cara kishte lindur në Palçishte, Tetovë (Kalkandelen, në kohën e turkut). Ishte një djalë shumë i qetë, prej familjës së madhe të Carajve të Maleve të Sharrit. Ai ishte organizatori i Kryengritjes Shqiptare të viteve 1843 dhe 1844. Si zakonisht, Instituti Maqedonas i Historisë në Shkup i mohon faktet dhe të vërtetën historike, e duke e klasifikuar këtë hero si "një shërbëtor të turqëve", që paska qenë thjeshtë organizator i një kryengritjeje kundër rekrutimit të myslimanëve në ushtrinë osmane". Asgjë më tepër! Asgjë më tepër! Por përmendja e historisë së Dervish Carës, sipas Institutit në Shkup s`qenka gjë tjetër vetëm se një "keqpërdorim nacional-romantik i historisë për qëllime poltike" (?). Sa larg jeni ju prej së vërtetës historike! Mosni ashtu, sepse edhe Aleksandar Markovski në vitin 1985, ka shkruar një libër me titull "Kryengritja e Dervish Carës", ku shpjegon qartë se kryengritësit shqiptarë kanë çliruar Shkupin dhe kështu ka dalë kërkesa e parë gjatë rilindjes shqiptare për Autonominë e Shqipërisë. Dervish Cara ka qenë një ndër kryengritësit më kryesorë të kryengritjes antiosmane. Mijëra luftëtarë të udhëhequr nga Dervish Cara çliruan Prishtinën, Shkupin, Tetovën, etj., ku ngritën edhe organet vetëqeveritare të pushtetit. Në vitet e përmendura, neve nuk na linin të shkruanim, e as që të merrnim shënime për veten tone,

për kohën kur juve sllavo-maqedonas as që ishit! Interesante sepse në atë kohë Serbisë i lejohej një autonomi, dhe ata i kishin edhe gazetat e tyre. "Serbske novine" (Gazeta serbe) e 17 majit të vitit 1844, në tekstin me titullin "Arnautlija" (Shqipëtari) shkruan se në Shkup kanë qëndruar mbi 20 mijë kryengritës dhe kanë luftuar kundër forcave osmane, të cilët kanë qenë të udhëhequr nga Dervish Cara. E shifni se gjërat që ne nuk kemi guxuar t`i përmendim, janë shkruar në kohë reale pikërisht prej atyre që më vonë as që na lejonin t`i përshkruajmë dhe t`i qesim në "duvakin" e përpjekjeve tona për pavarësi. "Por, e vërteta është një lloj uji i nxehtë që del nga toka, i cili shkrin dëborat dhe akujt që ka përqark, i bën për vete dhe shtohet duke shkuar. E sado që mund të ngrijë duke u ftohur ajri, pa kaluar shumë kohë prapë bëhet siç ka qenë (ujë i rrjedhshëm)", - ka thënë Sami Frashëri.

E njihni Tanzimatin? Sepse është i njohur Tanzimati dhe reformat e Tanzimatit të cilat shkaktuan burgosjen dhe likujdimin e Pashave shqipfolës: Abdurrahman Pashën e Kalkandelenit (Tetovës) dhe dy vëllezërit e tij, Hivzi-Pashën e Yskybit (Shkupit) dhe Hysen Pashën e Kjustendilit (sot qytet në Bullgari). Po, po shqipfolës në shërbim të Sulltanit dhe të xhepave të tij. Por edhe ashtu siç ishin, ata ishin të padëshiruar për kreun shtetëror të osmanëve. Dervish Cara e çliroi Shkupin. "Dervish Cara filloi kryengritjen e tij dhe kryengritësit morën Gostivarin dhe menjëherë në muajin nëntor iu drejtuan Tetovës (Kalkandelenit), në një luftë që zgjati tri javë. Tetova u bë qendër e kryengritësve. Jemi në janarin e vitit 1844. I përforcuar në Gostivar dhe Tetovë, ai përgatitej për Dibrën, Prizrenin, Prishtinën dhe Vranjen, por qëllimi i tij ishte Shkupi sepse e dinte që edhe aty i kishte përkrahësit. Në shkurtin e të njëjtit vit, pra 1844, u muarr Shkupi, dhe u formua Këshilli i Lartë

të cilin e udhëhoqi Dervish Cara, që ishte Trupi Suprem Organizativ i territoreve të çliruara. Pra Dervish Cara e çliroi Shkupin. Rruga e tij prej çlirimtari s`kishte të ndalur. Pas Kumanovës u çlirua Presheva, Bujanovci, Vranja dhe Leskofça (Leskovac). Kryengritja i përfshinte një nga një tokat shqiptare: Peja, Gjakova, Prizreni dhe Shkodra. Kryengritja dhe çlirimi në pranverën e vitit të përmendur 1844, e përfshinte Ohrin me Manastir në Jug, Shkodrën në Perëndim, Kosovën Veriore në Veri dhe Kumanovën në Lindje. Nuk ishte thjesht vetëm Shkupi. Ata i kërkuan edhe Pashait të Janinës që Sanxhaku i tij t`i bashkangjitej vëllezërve të tyre në luftën kundër Otomanëve; dhe qëllimi i qartë si loti: Automomia e Shqipërisë. Në vitin 1830, Serbisë iu dha autonomia por me shqiptarët veprohej ndryshe. Ushtria e Guvernatorit të Libanit me 30 mijë burra, u nis drejt Manastirit me artilerinë më të rëndë të kohës. Shtatori i 1844-ës ishte fundi i Autonomisë së Shqipërisë dhe i Dervish Carës. Dervish Cara u dënua vetë i njëzet e teti me dënimin më të rëndë, me vdekje. Pra nuk ishte në pyetje vetëm Shkupi. Pse për shqiptarët veprohej ndryshe?

"*Gjyshi i Karagjorgje Petroviqit, udhëheqësit të Kryengritjes së parë serbe, ka qenë Shqiptar dhe se ai është quajtur Gjin Marash Kelmendi", thuhet në librin "Karagjorgjeviqët- historia e mëshefur". Autorët e librit janë Milorad Boshnjak dhe Slobodan Obrenoviqi e edhe* Letrari dhe kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Duklës, Jevrem Bërkoviqi e vërteton të njëjtën për përkatësinë shqiptare të Karagjorgjeviqëve. Por përkundër faktit që ishin shqiptarë, ata ngritën krye për Serbinë. Dhe normalisht disa gjëra edhe në Perandorinë e madhe Otomane shikoheshin jo në mënyrë të njëjtë; dy njësi të ndryshme vlerësimi për ne (edhe për ju Sllavët e Maqedonisë) dhe

për serbët. Por sidoqoftë, edhe pse shqiptarët i udhuhoqën Kryengritjet e para të quajtura Serbe, ato fituan Autonominë e Serbisë. Pra shqiptarët luftuan për Serbi. Kurse në rastin e Dervish Carës u vërsul e tërë Perandoria kundër tij sepse kërkesat nuk ishin të njëjta me ato të nipit të Marash Kelmendit.

Juve sllavëve të Maqedonisë, Titoja iu mësoi keq të kaluarën tuaj, por edhe me ne veproi në të njëjtën mënyrë. Pse po e them këtë? Ju kujtohet Republika e Krushevës, Kryengritja e Ilindenit ? Pito Guli me shokë? Pra viti 1903. Edhe këta ishin shqiptarë por edhe këta turku nuk i deshti dhe i shkatërroi. E mjera Perandori ! Mendonte se do të jetë përjetësisht në këto toka. Vorbulla e historisë sonë gjithëshqiptare ishte marramendëse. Askush nuk mendonte se nga ato përplasje centripetale drejt vrimës së zezë, do të shpëtonim. Furtunat nga ato më të fuqishmet u munduan të na zhbënin, dhe të na hidhnin në vrimën e moskthimit, duke na mohuar të kaluarën tonë, duke na ç'rrënjosur nga trungu ynë mijëra vjeçar. Tjetërsimin tonë e kishin përparësi të përparësive, kush duke na shlyer dhe humbur historinë e kush duke na tjetërsuar në kombe të tjera me qëllim të caktuar, që të harrojmë vehten tonë, dhe kështu një ditë të na vijë turp me atë se çka ishim.

"Mbretëria serbe, nga viti 1913 deri në vitin 1941 ushtroi politikë tepër barbare ndaj popullsisë shqiptare, të besimit fetar mysliman, ortodoks dhe katolik, por edhe ndaj popullsisë maqedonase. Bile, maqedonasit as që i njihte për popull, kurse shqiptarët myslimanë mundohej t'i tjetërsonte në turq. Por ama, përqendrimin fillestar asimilues, pushtuesi serb e koncentroi ndaj popullatës shqiptare me besim ortodoks, duke e shpërdoruar për këtë politikë asimiluese edhe kishën nacionaliste serbe dhe besimin e tyre, prandaj shqiptarët ortodoksë i pati

"konvertuar" zyrtarisht në serbë." E kisha dikur një shok të mirë nga Maqedonia. Mitevski i thonin të ndjerit. Ai më shpjegonte se mbiemri i tij ndërronte sipas kohës, herë Mitiq, herë Mitov e në kohën kur ne njiheshim: Mitevski.

Si e bëmë ne shqiptarët, Malin e Zi?

Sipas të dhënave dhe artefakteve të fshehura me qëllime të caktuara, e të cilat po dalin në shesh përditë e më tepër, ne ishim ata që e mbollëm qytetërimin. Ne ishim ata që Evropës ia dhamë Evropën. Por neve pushtuesit na mbollën mosbesim, përçarje, grindje, frikë, pakënaqësi, dyshim. Na e mbillnin vëllavrasjen. Na mbillnin kob e zi. Pushtuesit e mbollën vdekjen. Ishim gjithmonë në gjendje "mbill e mos korr". Ku mbillnim nuk korrnim, nuk kishim mundësi t`i zënim këmbët në tokat tona se duhej gjithmonë t`i mblidhnim plaçkat e të iknim. Duhej të iknim e t`i shpëtonim masakrave, vdekjes, duhej shpëtuar diçka e kjo diçka është kjo që jemi sot.

"Deri në historinë më të re në Mal të Zi, shqiptarët dhe malazezët ishin në marrëdhënie shumë miqësore. Prishja dhe urrejtja ndërveti u bë kur malazezët filluan të "sllavizohen" apo kur shqiptarët filluan ta kalojnë në Islam? Gjithashtu vëllazëria shqiptare "malësore" a janë në fis me ato malazeze dhe disa në të vërtetë a janë shqipëtarë të shndërruar në malazezë apo e kundërta? E lexova këtë pyetje me mjaft kujdes. Pyetje që nuk është vështirë t`i përgjigjesh por duhet një qasje serioze, e sinqertë dhe gjakftohtë.

Por le të kthehemi në të kaluarën e largët kur këndej pari nuk kishte as serb e as turk. "Shqiptarët janë pasardhësit e drejtpërdrejtë dhe si të këtillë janë autoktonë që nga kohët e lashta, ku jetojnë edhe sot e kësaj dite në trojet e tyre në Shqipëri, Kosovë, në Maqedoni, Mal të Zi, në Serbi dhe Greqi e gjetiu". (Dr. Skënder Riza). Në asnjë dokument nuk ka shënime për ekzistimin e serbëve në këto troje, në ato kohë. Duke bërë fjalë për banorët e pronave të Manastirit të Deçanit, Manastirit të Graçanicës, Patrikanën e Pejës etj., prona këto që shtriheshin në një territor shumë të gjerë, siç e tregon "Bulla e Artë" e mbretit Stefan Deçan (1330), Dr. Rizaj do të na konstatojë se aty kishte vetëm shqiptarë. Kështu kuptojmë se popullata e Kosovës së sotme dhe qeveritarët e saj Nemanasit-Nimanasit-Nemaniqët, të gjithë ishin ilirë tribullë (tribalë, fis pellazgë-ilir) njëherë katolikë e pastaj nga Milutini e këndej Shkizmatik (shqiptarë ortodoks) dhe se do të jetë plotësisht e natyrshme që edhe kishat dhe manastiret e këtij ambienti gjeografik si institucionet e shenjta fetare të kësaj popullate shqiptare dhe të sundimtarëve të saj, të jenë ndërtuar nga ata dhe atyre u takojnë. Kur Stefan Nimani e pushtoi Malësinë (Doclean, shek. XI-të), ai shkruante se i ka shkatërruar të gjitha qytetet bregdetare, por "ai kishte asgjësuar edhe monumentet Latine duke ia vënë zjarrin kishave lokale katolike dhe librave që gjindeshin në to." Ju kujtohet Shasi Ilir i 365 kishave? E kisha cekur zonjën Edith Durham ("Some tribal Laës and Customs of the Balkans", Londër, 1928) e cila shkruante se gjatë qëndrimit të saj në këtë pjesë të Ballkanit (Shqipëri dhe Mal të Zi F.Xh.) gjatë vitit 1913 (pra shek. XX), nuk ishte e lejuar që vajzat e Drekaloviqëve të martohen me djemt e Kastratëve "se janë të një gjaku". Por për këtë më vonë. Rreth vitit 1054 u bë ndarja e madhe shkizmike e Kishës së Lindjes si rezultat i mospa-

jtimit në mes lindjes e perëndimit. Shqiptarët që iu bashkëngjitën shkizmit (shki, shka, shkja, shkije), më lehtë e patën të përvetësohen nga kisha e tyre ortodokse. Pra në atë kohë kishte shka-shqiptar otodoks ende i pasllavizuar dhe serb-kurrkushi i ardhur. Stefan Nemana, Nimani, Nemaniqi, kishte lindur afër Podgoricës ku nuk kishte prift ortodoks dhe u pagëzua me ritet perëndimore katolike. Nga fisi Nimanaj i Gashëve rrjedh Stefan Nemanja, Mbret i Shqiptarëve, Serbëve, Vllehëve dhe Grekëve pra i Bizantit. Stefani ishte kushëri i parë i princit shqiptar Dhimitër që njihet si themelues i derës së Dukagjinasve. Stefani është i varrosur në Manastirin Hilendar në Greqi në mali Atos, dhe në varr është epitafi me shkronja greke si Stefan Nimani e jo Nemanja. Por të kthehemi në temë. Si ndodhi që "Malësia" të bëhet "Mal i Zi", pra ne shqiptarët të bëjmë Malin e Zi? Shkrimi do të jetë i fragmentuar që të mos ngjajë me një studim të mirëfilltë historic, por të jetë më tepër një nxitje për historianët dhe gjuhëtarët tanë, që ata të mundohen sa më shumë të na i "kthejnë" bijtë e Shqipërisë në gjirin e saj. Kush janë Berishajt? Berishajt i takojnë grupit të fiseve Puka dhe janë të parët në vendin e tyre në jug të fisit Krasniqi dhe Shala. Sipas gjermanit Franc Baron Nopça (Franz Baron Nopcsa, "Das Katolische Nordalbaniens", Budapest 1907), shenjat e para të fisit Berisha, mund të gjenden që prej 1270-ës. Nga këta Berishajt lindin shqiptarët ortodoks (shkijet) Drekaloviq, Kuqi dhe Gruda. I pari nga shkijet ishte Ndreu. Drekaloviqët ishin të afërm edhe me Kastratët. Fisi malazez Vasojeviq (pra shkije-shqiptarë ortodoks) ishin nga fisi ilir Kelmendi. Shënimet tregojnë që edhe gjuhëtari serb Vuk Karaxhiq ishte malazez me prejardhje. Por edhe Dinastia e Koagjorgjeviqëve, e më saktë edhe mbreti Petar Karagjorjeviq, ishte me prejardhje shqiptare, pra mala-

zez. Mark Milani Popoviqi është i njohur si armiku dhe asgjësuesi më i madh i qenies shqiptare në Malesi. (Mal i Zi). Që ai shkruante për sllavët, kjo na është e njohur, por më pak dihet që ai i kishte dy gjuhë amtare: serbishten dhe arbanishten. Si është e mundur që ai thoshte që gjuha mëmë e tij ishte arbanishtja? Sepse ai dinte rrënjët e tij dhe të fisit të tij. E dinte shumë mirë që në fisin Kuq ishin përzier gjaku sllav dhe ai arbanas. Në këtë përzierje dhe në këtë farefisni të fiseve arbanase dhe malazeze, ka qenë e ruajtur tradita e gjallë e martesave. Shkijet e Vrrakës (Shqiptarët ortodoksë të Vrrakës) janë të tillë vetëm se arbanas dhe malazez të përzier ndërveti, e që nuk kanë aspak lidhje me serbët. Rol tjetër asimilues të arbanasve të Malësisë kishte edhe Turku. Me ndërrimin e fesë në sanxhakun e Novi Pazarit, shqiptarët e humbën edhe gjuhën. Ndërkaq tek "Kamus-ul alam" (1889-1898), enciklopedia e parë në Turqi, Sami Frashëri shkruan se në këtë sanxhak "në përgjithësi popullsia është shqiptare. Vetëm një pjesë e popullsisë së kazave të Gucisë e Beranës flasin sllavisht, por dinë edhe shqip (dinë shqip se ishin shqiptarë, F.Xh) dhe nuk dallohen nga shqiptarët për nga doket e zakonet". Pra në veshje, doke dhe zakone ishin të njëjtë. Pra? Por si flitej deri në atë kohë kur zyrtarisht pranohet se gjuha malazeze (cërnogorski jezik) zyrtarizohet pas gjysmës së parë të shek XIX-të? Sigurisht që shqip. Humbja në gjirin sllav ishte e pakthyeshme si humbja në gjirin turk e grek. Por kur jemi tek Malësia, duhet të cekim edhe këto ndërrime të fiseve nga e folmja shqipe në atë sllavishte: Gjuka –Gjukiq, Gjukanoviq; Boja – Bojoviq, Bojiq; Bojku- Bojkoviq; Gashi- Gashiq, Gashanin; Berisha-Berishiq; Burri-Buriq; Shoshi-Shoshkiq; Shala-Shaliq, Shalanin, Shalunoviq; (E njohur në një fshat të Plavës ku jetonin të tri palët: si shqiptar Shala, si boshnjak Shalunin dhe si malazez Shaliq);

Gjurka - Gjurkoviq; Gjoka- Gjokiq ,Gjokonoviq; Gjeli – Gjeloviq, Gjeliq; Gruaja – grujiq; Gruda- Grudiq; Zogu –Zogoviq; Balaj- Baliq, Baloviq; Peshku-Peshkoviq; Lulaj-Luliq, Luloviq; Nikqi- Nikqiq; Brala-Braliq; Daci- Daciq; Dashi- Dashiq; Bardhi- Bardiq; Preni- Preniq; Kola- Koliq; etj., etj. PoVasojeviqët (Vasa), Bjellopavliqët (Palabardhë), Drekalloviqët (Ndrekajt) ? Njëri shkruante në një rast: "Pa më thuaj oj Shqipëri, kur do i mbledhësh bijt' e tu në gjiun tënd ?" Qëllimi i shkrimit nuk ishte t`i mbledhim në gji (Pse jo?) të gjithë ata që për arsye të ndryshme e zvogëluan numrin tonë, por të tregohet për vazhdimësinë shekullore të asimilimit të tyre. E pse ata në shumë raste ishin armiqtë tanë shumë të rrezikshëm dhe shfarosës, fajet janë të shpjegueshme. Se shqiptarët janë "ushqyesit" më të mëdhenj të fqinjëve tanë, kjo është e dokumentuar. Se shqiptarët janë edhe formues të shtetit të fqinjëve, kjo është më së e vërtetë. Në rrethin tonë fqinjësor që ngaMali i Zi, Serbia dhe Greqia, shqiptari ishte faktori kryesor shtetformues. Në kohën e largët disa shekuj apo disa dekada, ne jemi ata që në mënyrë direkte apo indirekte i formuam këto shtete. Kush ndikoi që shqiptari të mohojë vetveten dhe të vihet në krye të formimit të shteteve fqinje? Si dhe pse u zhvilluan rrethanat që shqiptari të bëhet edhe vrasës i vëllezërve të vet edhe pushtues i tokave të veta nën flamurin e tjetër kujt? Na e mbillnin vëllavrasjen.Na mbillnin kob e zi. Pyetjes se kur shqiptarët u bën malazez, kur malësorët u sllavizuan apo kur u islamizuan, unë i kthej përgjigje se kjo ka ndodhur në vazhdimësi gjatë shekujve, ndër shtypjen e furtunave historike. Pra ka te bëjë edhe me arsyen e ndarjes së kishës sepse në një moment historik, gjatë kohës së "çlirimtarëve" otomanë, popullata jonë ortodokse, i ka pasur vetëm dy mundësi: të mbetet ortodoks dhe të sllavizohet, ose të islamizohet e "turqizohet" që

kinse të shpëtojë nga sllavizimi. Pra shkak i ndarjes edhe më të madhe të shqiptarëve otodoks-shkijeve të tokave tona në Mal të Zi, Maqedoni, Serbi dhe Kosovë nga trungu shqiptarë, ka qenë edhe politika favorizuese e turkut që i ka bërë sllavëve nën presionin rus, për zhdukjen e elementit katolik shqiptar. Pra si e thashë edhe më lart, nuk mbetej gjë tjetër për ne: ose sllavë ose muhamedanë. Ishim gjithmonë në atë gjendjen: "mbill e mos korr". Por mos të na duket cudi se miliona shqiptarë ortodoksë të Malit të Zi, Serbisë, Maqedonisë dhe Greqisë e humbën kombin për shkak të fesë, sepse e njëjta gjë ndodhi edhe me miliona shqiptarë mysliman që për shkak të fesë e harruan shqiptarinë, siç janë Sanxhaku i Novi Pazarit dhe shqiptarët e Turqisë.

Serbia, djepi i civilizimit Romak. Mos more!

"Shqiptarët me shekuj e dekada kanë përjetuar ç`kulturim, prandaj është koha të rimendohet kjo dhe të rikthejmë besimin tek vetja dhe te rruga jonë e përbashkët për të qenë pjesë e Shpirtit të Europës së Bashkuar."

Lis Bukuroca

"... Shqiptarët flasin një nga gjuhët më antike dhe më të bukura të botës. Gjuhët e ngjashme me Shqipen janë zhdukur disa mijëra vite më parë dhe nuk fliten më në asnjë vend të tokës. Greqishtja antike, Latinishtja, Sanskrishtja, gjuha antike e Indisë, gjuha Zend që ishte gjuha antike e Persisë dhe së fundmi gjuha Kelte dhe ajo Teutonike, që të gjitha këto gjuhë janë të vdekura, ndërsa gjuha jonë e cila midis tyre është më e vjetëra, jeton e flitet akoma edhe sot, si në kohën e Pellazgëve... " (Sami Frashëri). E fillova shkrimin tim me këtë testament të Sami Frashërit i cili na bën të jemi krenarë për gjuhën që flasim dhe kombit që i takojmë. Ne jemi trashëgimtarë të një historije të lashtë, histori e cila është lakuar dhe përshtatur për nevojat e veta nga ata që nuk kishin histori. Rastësia i ka sjellë në këto toka, nuk dua të humb kohë duke folur për ardhjen e tyre. Ata donin vazhdimisht dhe duan ende

sot të mashtrojnë pasardhësit e tyre po me ato "histori" nga të cilat u mashtruan vetë nga paraardhësit e tyre. Ne e dimë vendlindjen tonë, e njohim gjeografinë tonë dhe e dimë se si mbimë në këto toka. Ardhacakët, problemin më të madh e kanë në identifikimin e vetvetes, duan të çertifikohen në një adresë e cila nuk ishte e tyre, duan të bindin botën se janë nga aty ku gjenden sot; nëse bota "ushqehej" me këto teorira, tani jemi ne që po asaj bote i tregojmë të vërtetën e bazuar në fakte, dhe ajo, deshti apo nuk deshti, nuk mund t`i mbyllë sytë para të vërtetës, së vërtetës historike. "Nga burimet historike, të lidhura me Dioklenë, shënimi më i thuktë është ai i Pop Duklanit i cili në Udhëpërshkrimin e tij, tregon për ndodhitë e rëndësishme që nga shekulli IV deri tek shekulli IX. Në fillim ai (pop Duklani) shkruan se paraardhësit e serbeve, Gotët, kanë ardhur në kohën e Carit Anastasi. Kjo lidhshmëri e Gotëve me Serbët vjen në kohën e Arkixhakonit Tomas; për të, gotët dhe serbët ishin "arianë" -heretikë. Përktimin e Biblës gotike e kanë bërë Alanët (Serboijët) dhe atë e predikonin në kishat e tyre. Kjo vazhdoi me ardhjen e tyre në këto anë, që nga shekulli i I-IV ".(dr. Jovan I. Deretiq, "Serbia para Imperatorisë së Romës") Serbët, duke kërkuar në "kohën e tyre të humbur", gjetën shumë lokalitete të rëndësishme për civilizimin europian dhe atë botëror por më të rëndësishmit sipas tyre qenkan dy qytete romake dhe dy Pallate Mbretërore në tokën e Serbisë së sotme. Në hulumtimet e tyre arkeologët serbë e "kapën" kohën në të cilën kishin lindur edhe dyperandorë të cilët kishin ndikim të madh në shekujt pas tyre: Konstantini (306-337) dhe Justiniani (527-565). Terrenet tona, -thotë Dragoslav Srejoviq, janë organikisht të lidhura. Serbia është Piemonti i Balkanit në aspektin territorial dhe kulturor. Ky ishte vendi më i plleshëm i krijimtarisë njerëzore, dhe pa e ditur se

çka ka ndodhur në këto anë, nuk ka as arkeologji ballkanike, as europiane juglindore e as botërore. Sa më shumë që lexoj shkrimet serbe në lidhje me "të kaluarën" e tyre të bujshme, aq më shumë po mësoj të kaluarën tonë. Të dhemb zemra nga mohuesit tanë të cilët mundohen në çdo mënyrë të na bëjnë të huaj në tokat tona. Serbia, vendlindja e 17 Perandorëve romakë është e vërtetë por jo si Serbi. Është e vërtetë që në atë tokë të huaj ku ata jetojnë sot, kanë lindur të gjitha të mirat e kulturës -trashëgimisë së kulturës botërore por kjo ka ndodhur kur aty jetonin të tjerët para tyre.

"**Shekulli i tretë i kësaj epoke njihej si shekulli i krizës dhe e mrekullisë së shpëtimit të Perandorisë së Romës nga shkatërrimi, shkatërrim i cili u ushtrua për dy-tre shekuj më vonë. Që nga koha e lindjes së Imperatorit të parë romak e deri në shkatërrimin e saj, në tokat tona serbe kanë lindur 17 Imperatorë", – thonë arkeologët serbë. Le ta thonë sepse atyre nuk jua prishin mohuesit tanë ; por pohuesit e tyre dhe mohuesit tonë, vërtetojnë shtrembërimin djallëzor të historisë.**

Serbët zbulojnë dhe nuk i fshehin ato që zbulojnë në tokën e vjetër që tani e quajnë Serbi; arkeologët e tyre të vyeshëm, me një ndjenjë të posaçme të krenarisë së vjedhur në vitin 1996, kanë zbuluar gjurmët "bindëse" të trashëgimisë serbe si djep i civilizimit romak. Në afërsi të Negotinit, u zbulua mauzeliumi i shekullit të tretë. U gjetën: kompleti i stolive të arit në 38 pjesë reprezentative i cili i përkiste nënës së Maximus Daias-it, njërit nga katër perandorët romakë që nga periudha e katërshes. Serbët, ia dinë shumë për nder pionerit të arkeologjisë

serbe dr. Janko Shafarik i cili i pari që në vitin 1846 e ka përqëndruar vëmendjën e shkencës në vlerat e lokalitetitit arkeologjik që sot dihet se ishte pallati imperatorik i dhëndërit të Dioklecianit, Feliks Romulianit. Ai, që në atë kohë, Gamzigradin e futi në listën e vendzbulimeve arkeologjike të cilat duhen ç`groposur "**nën udhëheqjen e njeriut që i kupton gjërat"**. Shafariku, të gjitha zbulimet arkeologjike i bënte nën mbështetjen e Pricipatës së Serbisë dhe shpenzimet mbuloheshin nga shteti. A kemi në njeri që i kupton gjërat?

E çuditëshme! Sa ishin ende nën zgjedhën turke, ata mendonin për krijimin e historisë së tyre. E rrejshme apo jo e kaluara e tyre, ata që në atë kohë mendonin për të ardhmen. Po e përsëris, ende ishin nën turkun dhe që në atë kohë kërkonin të kaluarën e tyre "romake"; e në të njëjtën kohë, bënin plane për zhbërjen e banorëve që kishin rrënjë në ato toka. Shpërnguljet me dhunë të shqiptarëve të asaj kohe nga ato anë, gjakojnë ende. E çuditëshme ! Sot, bashkëvendasit tanë na anatemojnë se pse po i zbulojmë të vërtetat historike; jo pse po i zbulojmë sepse ato janë të zbuluara por pse po i publikojmë. Sirmiumi (Mitrovica e Sremit) e kishte farkëtoren e monedhave, edhe pse ende data e saktë e themelimit të saj nuk dihet por ruhen monedhat e arta të Konstantinit në të cilën është shkurtesa SIR(mium). Imperatori aty farkëtonte monedhat me fytyrën e tij, të gruas së tij dhe s`ëmës Helenës e të bijëve. Një fjalë e urtë popullore thotë: "Nëse nuk e punon arën tënde, të huajt e ngulin plugun në të" ose "Nëse nuk e kosit livadhin tënd, kafshë të huaja do ta kullosin barin në të". A kanë të vërtetë dhe ngjashmëri këto thënie popullore me sjelljet tona? Ne, sidomos viteve të fundit, me të madhe po i sjellim jo lopët e huaja por hijenat dhe çakejt që të na shkyejnë mbi livadhet tona. Po e shkyejmë historinë

tonë; e harrojmë se populli pa histori është një popull jashtëtokësor (alien). Serbët e shohin aktivitetin e tyre arkeologjik si një të mirë që çon përpara historinë e Ballkanit. Ata thonë: "Është koha e fundit që të gjuhet në mbeturinën e historisë teoria e "ardhjes së Sllavëve" dhe se Ballkani e banorët e tij autoktonë janë të lidhura me arkeologjinë e popullit të tokave të këtij vendi (Pra Serbët). Mandej shtojnë edhe këtë tjetrën: "Nëse nuk gjuhet teoria e ardhjes së tyre nga Rusia, do të vazhdohet kolonializmi kulturor i Ballkanit". E kuptuam? "Zbulimet e reja janë përparim për në rastin e Ballkanit duhet të kthehemi pak mbrapa, disa hapa mbrapa, para se të fillojë përparimi", - thuhet nga ata. Kjo shumë mirë nënkuptohet me dëshirën e tyre që të shlyhen gjurmët historike të një populli të dikurshëm e të sotëm, shqiptarëve. Libri, në mesin e qindra librave, i autorit Aleksandar Jovanoviq "Serbia vendlindja e Imperatorisë së Romës", 2006, e botuar në gjuhët kryesore të Europës, përmend: "Serbia, vendi ku lindën 17 Imperatorë të Romës antike, paraqet hapësirën e gjurmëve impresive të të famshmëve të Imperatorisë(27 prk- 476 psk). E gjithë kjo dokumenton që Serbët janë kreatorë dhe pronarë të kulturës themelore të Europës në tërësi, dhe që Serbët ishin gjithmonë në Ballkan dhe asnjë tregim i trilluar e i qëllimshëm për njëfarë ardhje në Ballkan, zoti e di në të cilën kohë, më nuk qëndron. Sa më shumë zbulime dhe shkrime nga ana jonë, bazuar në dokumente dhe artifakte, do të sjellë ujë të pastër në përhapjen e të vërtetës së vërtetë dhe të vërtetës së popullit të parë, të vetëm dhe më të lashtë të Ballkanit - Serbëve". Një gjë më brengos për këtë libër; ndoshta do t`iu shërbejë oliver shmitave si literaturë e mandej do të na mbushin mendjen se na nuk ishim të këtushëm. E pastaj në "zadrugën e Zueckenbergut (FB)", do të humbim kohë të tërë duke debatuar se sa

të mençur na qenkan schmittat dhe si po e ditkan historinë tone. Zadrugari i mirë (shmitat) le që na shet mallra (libra historik), por shkyen një copë letër nga thesi i miellit edhe vendos mbi të një "narezak", një qepë, do fafarona dhe një kallabllak birra… sa me i mbajt myshteritë në zadrugë. Zotërinjtë falsifikatorë mendojnë se ne ende jemi të tillë ! Atyre iu duket e tepërt të flasin për veprat e Buxhovit, se "presin derisa ai të përfundojë hulumtimet e tij shkencore për fiset shqiptare në Afrikë, Azi, Oqeanin Paqësor, Sibir, Bregun e Fildisht" dhe punën e tij e shohin më shumë si humor. E bukur kjo? Ju pëlqen? Dikujt po e dikujt jo! Ne jemi ende të ndarë, ende debatojmë, ende kërcënojmë për të vërtetën tonë të vjedhur nga serbët. Gjon Keka shton edhe këtë: "Shihet tepër qartë se tek kombi ynë, një pjesë e tij nuk është ende e lirë nga të gjitha llojet e supersticioneve sulltaniste si ato te veseve dhe sindromeve, gjë kjo që jo vetëm se e dëmton rrugëtimin e vendit por edhe prish imazhin e identitetit europian, të kombit shqiptar në përgjithësi". Ta kemi të qartë edhe këtë, se jemi duke vuajtur shumë nga demagogjia e njerëzve të këqinj dhe heshtja e njerëzve të mirë. Kush jemi? Çka jemi ? Për kënd jemi? E duam ne vetveten?

Gënjejnë që të mashtrojnë apo popujt që e vjedhin historinë ?!

"E gjithë kjo çka po ndodh në Maqedoni, e ka edhe mënyrën shqiptare të përgjigjes së qytetëruar. Si ? Plisi i bardhë. Plisi i bardhë është harruar. E kemi harruar Plisin e bardhë që edhe Pirroja e bartte , edhe Odiseu por edhe Aleksandri i Madh. Bota pa dashur ka filluar të harrojë se aty jetojnë shqiptarët në tokat e veta".

Ardhacakët sllavë, si serbët ashtu edhe sllavomaqedonasit, për të "bindur" vetveten dhe botën për gjoja origjinën e tyre të "lashtë", e në të njejtën kohë për t`u treguar një "autoktoni" , shërbehen me shumë metoda, e që të gjitha themelohen në principin e rrenës. Jo pse e them unë por ata vetë e marrin si krenari, virtytin e gënjeshtrës historike: "Gënjejmë që ta mashtrojmë vetveten, ta ngushëllojmë tjetrin, gënjejmë nga dhembshuria, gënjejmë që të mos kemi frikë, të trimërohemi, ta fshehim varfërinë tonë, gënjejmë për shkak të ndershmërisë sonë. Gënjejmë për liri. Gënjeshtra është formë e patriotizmit dhe inteligjencës sonë. Gënjejmë në formë krijuese, imagjinuese dhe inventive". (Kështu thoshte Dobrica Qosiqi, akademik i besueshëm dhe kreativ serb) E bota iu ka besuar dhe ende iu beson. Ndoshta bota e dijnë të vërtetën por diçka nuk është në rregull kur iu besohet aq shumë sa që edhe e "vërteta" krijohet dhe besohet nga rrena. Mua s`më kishte bërë

përshtypje se rrejnë dhe përvetësojnë të huajën sikur të mos e kishim ndjerë këtë në lëkurën tonë. Ata aq shumë "tregojnë" dhe shpifin e rrejnë, sa që i kanë bindur edhe popujt e tyre për një të qenë që kurrë nuk ishte. Serbët me dokrrat e reja të Akademisë së tyre të Shkencave po e bindin popullin e vet që janë Ilirë, se janë në tokën e tyre të lashtë por në të njëjtën kohë duke ia mohuar vehtes të vërtetën e një ardhacaku nga stepat e pas Uralit; kurse sllavët e Maqedonisë që rastësisht historia i ka përplasur në këto toka e rrejnë vehten se janë trashëgimtarë të Maqedonasve të Aleksandrit të Madh. E bota qëndron duarkryq dhe ndoshta edhe pajtohet. Por si i thonë një fjale: "Heshtja është pranim!" Lind pyetja, pse historiografia europiane nuk reagon? Si mundet që Shkenca e historisë europiane të heshtë pas këtyre gënjeshtrave dhe përvetësimeve të paturpshme? Por ndoshta presin nga ne. Mund të thonë se shqiptarët sot i kanë dy shtetet e tyre, i kanë historianët e vet, i kanë Akademitë e veta; dhe ata le të përgjigjen, ata le t'i kundërvihen këtij tërbimi historik që nuk ka të ndalur me shekuj. Ndoshta edhe presin që të shohin se a jemi pjekur në atë masë, aq sa të jemi të aftë të kundërvihemi dhe të përgënjeshtrojmë, të përgënjeshtrojmë apo jemi aq të ndërthurur në interesa personale e politike sa që nuk na bën përshtypje se çka po na vidhet. E ku është roli i intelektualit këtu? I intelektualit tonë? "Tani për tani është e pamundur studimi i të kaluarës së shqiptarëve me metoda arkeologjike ngase nuk ka gjurmë për to. Kjo s`është e jashtëzakonshme sepse shqiptarët e sotëm janë një përzierje e komponenteve të ndryshëm etnike, gjegjësisht kulturave të ndryshme. Janë blegtorë të ardhur dhe kështu në mënyrë arkeologjike janë të padiktueshëm (që nuk vërehen). Gjurmët e tyre duhen kërkuar nëpër varrezat e tyre nëpër bjeshkë, e vështirë që gjindet diçka e mirëfilltë".

(Vesna Peshiq: "Shqiptarët- Ilirë të rrejshëm"). Slobodan Jarçeviq: "S`ka pasur dyndje të sllavëve në Ballkan, ata janë banorët e parë të Ballkanit dhe Panonisë. Ajo çka është e rëndësishme për popullin serb, e për këtë duhet edhe pasur kujdes, përveç të tjerëve edhe faktori shtetëror dhe pushtetarët, është që e vërteta për të kaluarën e formëson sjelljen e individit, kolektivit dhe kombit." E shihni pra kush qenka i ardhur këtu e kush është i vendit? Por jo. Studiuesi gjerman Johan Gfon Hani, që në fillim të veprës së tij "Studime shqiptare" botuar më 1854, shtron çështjen e prejardhjes së shqiptarëve dhe thotë: "Meqë shqiptarët nuk janë sllavë dhe nuk lidhen ngushtë me ndonjë nga popujt e tjerë që njohim, meqë burimet që kemi nuk flasin për ndonjë shtegtim tjetër (veç atij sllav) i cili të ishte aq i madh, duhet pranuar se shqiptarët e sotëm janë banorët e hershëm parasllavë të atij vendi." "Edhe Shën Jeronimi i shekullit 4 ps.k. i cili e përktheu Biblën nga hebraishtja, ishte serb", sipas dr. Doretiqit. Janë shumë shkrues joserbë që e kanë vërtetuar prejardhjen serbe të Shën Jeronimit. Është intersante të ceket që prof. dr. Gjorgje Jankoviq, arkeolog, i cili i ka hulumtuar varrezat e shekullit 4-6 ps.k. në Dalmaci, Bosanska Krajinë, Hercegovinë dhe në Serbinë Perëndimore, ka vërtetuar se ato janë serbe. Nëse arkeologu Jankoviq në rrethinën e Bosanska Grahovës ka gjetur varreza serbe të fillimit të shekullit 4 ps.k., dhe në rrethinën e këtij qyteti serb në Bosanska Krajinë ka lindur Shën Jeronimi në vitin 330 apo 337 ps.k., atëherë vërtetohet e vërteta për përkatësinë serbe të këtij të Shenjti." "Gjeografi më i madh i kohës, akademiku i dëgjuar aleksandrin Klaud Ptolemeu, qysh në shekullin II (125-161) dëshmon se në Maqedoninë mestokësore janë qytetet Arnisa e taulantëve, Elima e elimiotëve, Amantia në Orestis, Albanopolis i albanëve, Orma, Europus dhe Apsalus të almopëve. Këto fakte

i mbështet edhe studiuesi i mirënjohur Muzafer Kortuki ku thotë se Albanët, ishin aty me siguri edhe disa shekuj më parë prej kohës që ishin shënuar në hartën e këtij gjeografi antik. (Edibe Selimi–Osmani) Dr. Don Gaspër Gjinit, Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj, ndër të tjerat shkuan se: Dardania ishte një krahinë e veçantë kishtare dhe administrative. Selia e parë ipeshkvnore në Dardani, me sa dihet deri tani ka qenë në qytetin e Scupit. Ilirët (shqiptarët) kanë filluar të kalojnë në krishtërim shumë herët. Madje, dihet se edhe Shën Pjetri dhe Shën Pali, apostuj të Krishtit, pra,bashkëkohës të tij, kanë predikuar fenë e re ndër shqiptarët në Iliri. Filozofi Maksim nga Tiri i cili jetoi në kohën e Antonomit, në librin e tij: "A duhet t'u ngrihen perëndive shtatore", përmend se Peonët, fis ilir në Maqedoninë e sotme, e adhurojnë diellin në formën e një disku të vogël, të ngritur mbi një shtyllë të gjatë. E pyesim Mirjana P. Mirçevskën, se cili popull në Maqedoninë e sotme është më i hershëm, ata me vepër që nga vitet 1210 në gjuhën shqipe me alfabet latin apo gramatika e Bllazhe Koneskit e vitit 1945? Ja se çfarë shkruan zonja Edith Durham në librin e saj "Brenga e Ballkanit": "… e vërtetë është se dialekti i sllavishtes maqedonase nuk është as serbisht e as bullgarisht por midis, ndërmjet, ashtu si është vetë ai". "… Këta sllavishtfolës, në krahinat që i vizitova unë, janë më të ulëtit dhe më mendjecekëtit e të gjithë popujve të Ballkanit, ose në çdo vend tjetër, ata janë populli më i urryer i racës njerëzore. Më të paaftë se popujt tjerë dhe kanë rënë shumë më poshtë se popujt tjerë. Disa mendojnë se kjo çështje, denigrimi i tyre ka ardhur nga shtypja. Unë mendoj se ky shkak është pjesërisht i saktë. Ata kanë vuajtur më shumë se janë më të pazotët". Çka duhet më tepër të thuhet e të bisedohet për këta hajna të historisë sonë? Pse ne na duhet që vazhdimisht të jemi të zgjuar dhe

si bariu të ruajmë livadhet tona e kopenë tonë nga ujqërit e tërbuar? Është për t'u habitur se si Sllavo-Makedonia, nga një realitet fiktiv, nga një imagjinatë gllabëruese e serbëve, bullgarëve dhe grekëve, u krijua si "shtet" në dëm të tokave tona. E ata në pafytyrësi (me aprovimin në heshtje të shqiptarëve) krenohen me një të kaluar e cila aspak nuk iu përket. Përveç falsifikimit të historisë, shqiptarët duhet të durojnë edhe provokimet e njëpasnjëshme të qeverisë maqedonase që nëpërmjet inskenimeve të ndryshme të bandave huligane, ç`orienton vëmendjen e botës. Ku jemi ne?

Shënime për autorin

Fahri Xharra Lindur më 4 prill 1951, jeton në Gjakovë. Fahri Xharra është inxhinier i diplomuar ne Universitetin e Ljubjanës në degën e Shkencave Natyrore Teknologjike. Me përvojë shumëvjeçare ndërkombëtare, Xharra punoi në ndërmarrjen zvicerane "Bezema" si drejtor i shitjes ne Azinë Qendrore nga viti 2004, në Zvicër.

Më herët punoi si drejtor i shitjes për Evropën Juglindore në ndërmarrjen zvicerane CIBA, në Selanik dhe drejtori i shitjes për Afrikën Veriore, në Marok. Në Kosovë ka punuar si shef laboratori dhe drejtor prodhimi në ndërmarrjen "Emin Dukaru" në Gjakovë.

Ka drejtuar edhe ndërmarrjet Përpunimi dhe Tjerrtorja në Gjakovë. Zotëron shumë gjuhë të huaja përfshirë këtu gjuhët frënge, angleze, serbo-kroate, sllovene, gjermane, italiane, rumune, arabe, ruse, greke, e bullgare.

Përmbajtja

Kultura e Vinçes dhe të parët tanë 5
Kalashët e hundëzakëve në rrezik nga zhdukja e përhershme 11
Hundëzakët – Leshkuqët e Lekës së Madh 15
Kultura e Komanit 19
365 Kishat e Shasit 24
Antika e mohuar, Kale-ja e Bujanocit 29
Ne, Serbia dhe Europa 33
Ne ishim aty, Meduni Labeat Ilir! 38
Pse heshtim ne? Pse e duam historinë pa heronjë? 42
Pse i vranë Aristidh Kolën dhe Luka Çiçipin ? 47
Dervish Cara dhe Gordana Jankullovska ! 53
Si e bëmë ne shqiptarët, Malin e Zi? 59
Serbia, djepi i civilizimit Romak. Mos more! 65
Gënjejnë që të mashtrojnë apo popujt që e vjedhin historinë ?! 71
Shënime për autorin 77

ISBN 978-9951-641-38-8